

GJKATA SUPREME E KOSOVËS

PRISHTINË

Numri i lëndës: PML-241/15


Data: 19 prill 2016

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë prej gjyqtare së EULEX-it Anna Adamska-Gallant, kryetare e kolegjit dhe gjyqtare referuese, gjyqtarit të EULEX-it Krassimir Mazgalov, dhe gjyqtare së Gjykatës Supreme Nesrin Lushta si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga këshilltari ligjor i EULEX-it Adnan Isufi, në cilësi të procesmbajtësit,

Në çështjen penale kundër të pandehurve:

1. V [REDACTED] [REDACTED]
[REDACTED]
2. S [REDACTED] [REDACTED]
[REDACTED]
3. G [REDACTED] [REDACTED]
[REDACTED]
4. G [REDACTED] X [REDACTED] [REDACTED]
[REDACTED]
5. Q [REDACTED] R [REDACTED] [REDACTED]
[REDACTED]
6. M [REDACTED] A [REDACTED] [REDACTED]
[REDACTED]
7. S [REDACTED] S [REDACTED] [REDACTED]
[REDACTED]
8. E [REDACTED] M [REDACTED] [REDACTED]
[REDACTED]




9. A [REDACTED] Z [REDACTED] [REDACTED]
[REDACTED]

10. J [REDACTED] S [REDACTED] [REDACTED]
[REDACTED]

të dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Gjilanit, nr. 53/13, të datës 16 tetor 2013, të ndryshuar pjesërisht me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR, nr. 145/2014 të datës 01 korrik 2015, për veprat penale në vijim:

1. V [REDACTED] [REDACTED] për kryerje të terrorizmit, në kundërshtim të neneve 109 (1.10), 110 (1) të KPK-së, tani e dënueshme me nenet 135 (1.10) dhe 136 (1) të KPRK-së dhe për organizim të grupit terrorist, në kundërshtim të nenit 113 paragrafit 1 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 143 paragrafin 1 të KPRK-së, me dënimin unik me 8 (tetë) vjet burgim dhe me gjobë prej 1000 (njëmijë) Eurosh;
2. S [REDACTED] J [REDACTED] për kryerje të terrorizmit, në kundërshtim të nenit 109 paragrafit 1.10. 110 paragrafit 1 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 135 paragrafin 1.10 dhe 136 paragrafin 1 të KPRK-së dhe për pjesëmarrje në grup terrorist, në kundërshtim të nenit 113 paragrafit 3 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 143 paragrafin 2 të KPRK-së, me dënim unik me 6 (gjashtë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim;
3. G [REDACTED] L [REDACTED] për kryerje të terrorizmit, në kundërshtim të nenit 109 paragrafit 1.10. 110 paragrafit 1 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 135 paragrafin 1.10 dhe 136 paragrafin 1 të KPRK-së dhe për pjesëmarrje në grup terrorist, në kundërshtim të nenit 113 paragrafit 3 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 143 paragrafin 2 të KPRK-së, me dënim unik me 5 (pesë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim;
4. G [REDACTED] X [REDACTED] për kryerje të terrorizmit, në kundërshtim të nenit 109 paragrafit 1.10. 110 paragrafit 1 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 135 paragrafin 1.10 dhe 136 paragrafin 1 të KPRK-së dhe për pjesëmarrje në grup terrorist, në kundërshtim të nenit 113 paragrafit 3 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 143 paragrafin 2 të KPRK-së, me dënim unik me 5 (pesë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim;
5. Q [REDACTED] R [REDACTED] për kryerje të terrorizmit, në kundërshtim të nenit 109 paragrafit 1.10. 110 paragrafit 1 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 135 paragrafin 1.10 dhe 136 paragrafin 1 të KPRK-së dhe për pjesëmarrje në grup terrorist, në kundërshtim të nenit 113 paragrafit 3 të




KPK-së, tani e dënueshme me nenin 143 paragrafin 2 të KPRK-së, me dënim unik me 4 (katër) vjet burgim;

M.A.

6. M. [REDACTED] për kryerje të terrorizmit, në kundërshtim të nenit 109 paragrafit 1.10. 110 paragrafit 1 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 135 paragrafin 1.10 dhe 136 paragrafin 1 të KPRK-së dhe për pjesëmarrje në grup terrorist, në kundërshtim të nenit 113 paragrafit 3 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 143 paragrafin 2 të KPRK-së, me dënim unik me 5 (pesë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim;
7. S. [REDACTED] S. [REDACTED] për kryerje të terrorizmit, në kundërshtim të nenit 109 paragrafit 1.10. 110 paragrafit 1 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 135 paragrafin 1.10 dhe 136 paragrafin 1 të KPRK-së dhe për pjesëmarrje në grup terrorist, në kundërshtim të nenit 113 paragrafit 3 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 143 paragrafin 2 të KPRK-së, me dënim unik me 5 (pesë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim;
8. E. [REDACTED] M. [REDACTED] për kryerje të terrorizmit, në kundërshtim të nenit 109 paragrafit 1.10. 110 paragrafit 1 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 135 paragrafin 1.10 dhe 136 paragrafin 1 të KPRK-së dhe për pjesëmarrje në grup terrorist, në kundërshtim të nenit 113 paragrafit 3 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 143 paragrafin 2 të KPRK-së, me dënim unik me 5 (pesë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim;
9. A. [REDACTED] Z. [REDACTED] për kryerje të terrorizmit, në kundërshtim të nenit 109 paragrafit 1.10. 110 paragrafit 1 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 135 paragrafin 1.10 dhe 136 paragrafin 1 të KPRK-së dhe për pjesëmarrje në grup terrorist, në kundërshtim të nenit 113 paragrafit 3 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 143 paragrafin 2 të KPRK-së, me dënim unik me 5 (pesë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim;
10. J. [REDACTED] S. [REDACTED] për furnizim dhe shitje të paautorizuar të armëve, në kundërshtim të nenit 372 të KPRK-së, dhe për mbajtje në kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 të KPRK-së, me dënim unik me 2 (dy) vjet e 2 (dy) muaj burgim;

Duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga:

1. Avokati mbrojtës M. [REDACTED] M. [REDACTED] në emër të të pandehurit M. [REDACTED] A. [REDACTED] më 14 gusht 2015,
2. Avokati mbrojtës D. [REDACTED] R. [REDACTED] në emër të të pandehurit S. [REDACTED] S. [REDACTED] më 24 gusht 2015;
3. Avokati mbrojtës S. [REDACTED] P. [REDACTED] në emër të të pandehurit G. [REDACTED] L. [REDACTED] më 14 tetor 2015;



4. I pandehuri V [redacted] më 13 gusht 2015;
5. I pandehuri S [redacted] më 18 gusht 2015;
6. I pandehuri G [redacted] më 31 gusht 2015;

Pas shqyrtimit të përgjigjes së Zyrës së Prokurorit të Shtetit të paraqitur në Gjykatë më 11 nëntor 2015,

Pas këshillimi dhe votimit të mbajtur më 14 mars 2016 dhe 19 prill 2016;

Në përputhje me nenet 436, 438 (1.2), dhe 439 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tani e tutje "KPP")

Merr këtë:

AKTGJYKIM

- I. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga avokati mbrojtës në emër të të pandehurit M [redacted] A [redacted] S [redacted] S [redacted] dhe G [redacted] L [redacted] dhe nga i akuzuari S [redacted] J [redacted] pranohen pjesërisht, dhe aktgjykimet e dy gjykatave, të Gjykatës Themelore të Gjilanit PKR nr. 53/13 dhe të Gjykatës së Apelit PAKR nr. 145/2014 anulohen në pjesën që i referohet të akuzuarit M [redacted] A [redacted] S [redacted] S [redacted] G [redacted] L [redacted] dhe S [redacted] J [redacted] si dhe lënda kthehet për rigjykim në Gjykatën Themelore të Gjilanit.
- II. Aktgjykimet e dy gjykatave, të Gjykatës Themelore të Gjilanit PKR nr. 53/13 dhe të Gjykatës së Apelit PAKR nr. 145/2014 anulohen në pjesën që i referohet të akuzuarit V [redacted] J [redacted] G [redacted] X [redacted] Q [redacted] R [redacted] E [redacted] M [redacted] dhe A [redacted] Z [redacted] pasi ekzistojnë arsye për të vendosur në favor të tyre.
- III. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga të akuzuarit V [redacted] J [redacted] dhe G [redacted] X [redacted] refuzohen si të pabazuara.
- IV. Në përputhje me nenin 435 paragrafin 4 të KPP-së, Gjykata Supreme e Kosovës urdhëron ndërprerjen e menjëhershme të vuajtjes së dënimeve të shqiptuara me aktgjykim të formës së prerë kundër të akuzuarve V [redacted] J [redacted], S [redacted] J [redacted], G [redacted] X [redacted], E [redacted] M [redacted] A [redacted] S [redacted] S [redacted], Q [redacted] R [redacted] E [redacted] M [redacted] dhe A [redacted] Z [redacted] por ata duhet të qëndrojnë në paraburgim derisa Gjykata Themelore e Gjilanit të marrë vendim për masën e sigurimit të pranisë së të pandehurve.

ARSYETIMI



I. Historia e procedurës

1. Më 20 shkurt 2013, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ngriti aktakuzë në këtë çështje.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë

2. Me aktgjykimin e datës 16 tetor 2013, Gjykata Themelore e Gjilanit shpall fajtorë të pandehurit

V [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR] G [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR] G [REDAKTUAR] X [REDAKTUAR] Q [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR]
M [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] dhe A [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] për:

Kryerje të terrorizmit nga (neni 109 (1.10), neni 110 (1) i KPK-së (të vjetër) tani e dënueshme me nenin 135 (1.10) dhe 136 (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sepse të akuzuarit, në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një grup terrorist të vetëquajtur të njohur si "Lëvizja e Lirisë", me qëllim të detyrimit të padrejtë të Qeverisë së Republikës së Serbisë të ndërpresë aktivitetet e saj policore në rajonin e Bujanocit, padrejtësisht të detyrojnë anëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të lënë vendin e tyre të punës, dhe padrejtësisht të detyrojnë "bashkësinë ndërkombëtare" për të vendosur forcat paqeruajtëse në rajon, dhe

- Ata, në bashkëkryerje kanë marrë në posedim dhe në kontroll në numër të pacaktuar të armëve (duke përfshirë pushkë, mitraloz, dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist "Lëvizja e Lirisë", në një lokacion të pacaktuar, duke filluar nga prilli 2012, V [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR] G [REDAKTUAR] X [REDAKTUAR], Q [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR] deri më 01 korrik 2012, S [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR] deri më 16 tetor 2012, G [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR] deri më 13 shkurt 2013, S [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] dhe E [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] deri më 16 tetor 2012, A [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] deri më 17 tetor 2012;
- V [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR] G [REDAKTUAR] X [REDAKTUAR] dhe E [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] në bashkëkryerje kanë marrë pjesë në një sulm duke dëmtuar kontejnerin e Policisë Kufitare të Serbisë të vendosur në Bujanoc, dhe u kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore policit të S [REDAKTUAR] B [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] duke qëlluar me armë të ndryshme, të gjitha të poseduara dhe të përdorura në mënyrë të paligjshme, një numër të papërcaktuar të fishekëve me kalibrin të ndryshëm (më shumë se 100). Sulmi ka ndodhur në Dobrosin më 28 qershor 2012 rreth orës 04:00;



- S [redacted] J [redacted] dhe E [redacted] [redacted] në bashkëkryerje me njëri tjetrin dhe me një numër të pidentifikuar të kryerësve të tjerë, kanë marrë pjesë në një sulm duke dëmtuar kontejnerin e Policisë Kufitare të Serbisë të vendosur në Bujanoc, duke qëlluar me armë të ndryshme, të gjitha të poseduara dhe të përdorura në mënyrë të paligjshme, një numër të papërcaktuar të fishekëve me kalibrit të ndryshëm. Sulmi ka ndodhur në Dobrosin (Komuna e Gjilanit) më 7 tetor 2012 rreth orës 21:35;


V [redacted] J [redacted] fajtor për organizim të grupit terrorist, neni 113 (1) i KPK-së (të vjetër) tani e dënueshme me nenin 143 (1) të KPRK-së, sepse ai ka organizuar dhe drejtuar një grup terrorist të vetëquajtur të njohur si "Lëvizja e Lirisë", duke siguruar armatim, uniforma dhe mjete të tjera të nevojshme për aktivitetet e grupit, duke vendosur se cilat aktivitete do të kryhen nga grupi, duke vendosur se kur, ku dhe nga kush duhet të kryhen aktivitetet e tilla, personalisht duke marrë pjesë në të paktën një prej sulmeve të kryera nga grupi, duke përgatitur objektivat politike të grupit, duke përfshirë marrjen e përgjegjësisë për sulmet e kryera nga grupi. Këto veprime kanë ndodhur në një vend të pacaktuar, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 1 korrik 2012;

S [redacted] J [redacted] G [redacted] L [redacted] G [redacted] X [redacted] Q [redacted] R [redacted] M [redacted] A [redacted]
S [redacted] E [redacted] M [redacted] he A [redacted] Z [redacted] jtor për:

Pjesëmarrje në grup terrorist, në kundërshtim të nenit 113 paragrafit 3 të KPK-së, tani e dënueshme me nenin 143 paragrafin 2 të KPRK-së, sepse i pandehuri, në bashkëkryerje me V [redacted] J [redacted] E [redacted] M [redacted] G [redacted] L [redacted] A [redacted] Z [redacted] G [redacted] X [redacted] S [redacted] S [redacted] M [redacted] A [redacted] dhe Q [redacted] R [redacted] kanë marrë pjesë aktive në grup terrorist të vetëquajtur të njohur si "Lëvizja e Lirisë":

- S [redacted] J [redacted] duke përpiluar marrjen e përgjegjësisë, duke kërkuar armatim, duke kryer veprat penale të përshkruara më lart¹, dhe duke vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimet e grupit. Këto veprime kanë ndodhur në një vend të pacaktuar në Kosovë, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 16 tetor 2012;
- G [redacted] L [redacted] duke vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimet e grupit. Këto veprime kanë ndodhur në një vend të pacaktuar në Kosovë, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 13 shkurt 2013;

¹ Pjesëmarrje në sulmin e datës 07 tetor 2012, në posedim të armëve; f. 4 – 5 e aktgjykimit



- G. [REDACTED] X. [REDACTED] duke kërkuar armatim, duke kryer veprat penale të përshkruara më lart², dhe duke vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimet e grupit. Këto veprime kanë ndodhur në një vend të pacaktuar në Kosovë, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 01 korrik 2012;
- Q. [REDACTED] R. [REDACTED] duke vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimet e grupit. Këto veprime kanë ndodhur në një vend të pacaktuar në Kosovë, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 01 korrik 2012;
- M. [REDACTED] A. [REDACTED] duke vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimet e grupit. Këto veprime kanë ndodhur në një vend të pacaktuar në Kosovë, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 01 korrik 2012;
- S. [REDACTED] S. [REDACTED] duke vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimet e grupit. Këto veprime kanë ndodhur në një vend të pacaktuar në Kosovë, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 16 tetor 2012;
- E. [REDACTED] M. [REDACTED] duke kërkuar armatim, duke vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimet e grupit, duke kryer veprat penale të përshkruara më lart³. Këto veprime kanë ndodhur në një vend të pacaktuar në Kosovë, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 01 korrik 2012;
- A. [REDACTED] Z. [REDACTED] duke vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimet e grupit. Këto veprime kanë ndodhur në një vend të pacaktuar në Kosovë, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 17 tetor 2012;

Në rastin e të pandehurve G. [REDACTED] L. [REDACTED], G. [REDACTED] R. [REDACTED], M. [REDACTED] A. [REDACTED], S. [REDACTED], S. [REDACTED] dhe A. [REDACTED] Z. [REDACTED] gjykata tregon se grupi terrorist "Lëvizja e Lirisë" ka kryer sulmet ndaj instalimeve të Policisë së Serbisë më 17 maj, 28 qershor, dhe 07 tetor 2012;


Të pandehurit janë dënuar si në vijim:

V. [REDACTED] me dënim unik me 9 vjet burgim dhe me gjobë prej 1000 (njëmijë eurosh) sipas nenit 39 (1) dhe (2) të KPRK-së që duhet të paguhet jo më vonë se 3 (tre) muaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë;

S. [REDACTED] J. [REDACTED] me dënim unik me 8 vjet burgim;

²Pjesëmarrje në sulmin e datës 28 qershor 2012, në posedim të armëve; f. 6-7 e aktgjykimit

³Pjesëmarrje në sulmin e datës 28 qershor, 07 tetor 2012, në posedim të armëve; f. 10-11 e aktgjykimit



G [REDACTED] L [REDACTED] me dënim unik me 5 vjet e 6 muaj burgim;

G [REDACTED] X [REDACTED] me dënim unik me 6 vjet e 6 muaj burgim;

Q [REDACTED] R [REDACTED] me dënim unik me 5 vjet e 6 muaj burgim;

M [REDACTED] A [REDACTED] me dënim unik me 5 vjet e 6 muaj burgim;

S [REDACTED] [REDACTED] me dënim unik me 5 vjet e 6 muaj burgim;

E [REDACTED] M [REDACTED] me dënim unik me 6 vjet e 6 muaj burgim;

A [REDACTED] Z [REDACTED] me dënim unik me 5 vjet e 6 muaj burgim.

Aktgjykimi i shkallës së dytë

3. Të gjithë të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës kanë paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Aktgjykimi i shkruar i Gjykatës së Apelit është përfunduar më 1 korrik 2015, dhe pastaj i është dorëzuar palëve.

4. Me aktgjykimin e përmendur, Gjykata e Apelit ka vendosur siç vijon:


Ankesat e avokatëve mbrojtës të të pandehurve V [REDACTED] J [REDACTED] S [REDACTED] J [REDACTED] G [REDACTED] L [REDACTED] G [REDACTED] X [REDACTED] M [REDACTED] A [REDACTED], S [REDACTED] S [REDACTED] E [REDACTED] M [REDACTED] A [REDACTED] Z [REDACTED] dhe J [REDACTED] S [REDACTED] dhe ankesat e paraqitura nga të akuzuarit V [REDACTED] J [REDACTED] dhe G [REDACTED] X [REDACTED] kundër aktgjykimit të lëshuar nga Gjykata Themelore e Gjilanit refuzohen si të pabazuara.

Ankesa e avokatit mbrojtës të të pandehurit Q [REDACTED] R [REDACTED] është pranuar pjesërisht. Aktgjykimi i apeluar është ndryshuar në pjesën e shqiptimit të dënimit i cili është ndryshuar nga 5 (pesë) vjet në 3 (tre) vjet burgim. Duke marrë parasysh dënimin me 2 (dy) vjet burgim të shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë për veprën penale të pjesëmarrjes në grup terrorist nga neni 113 (3) i KPK-së, dënimi unik është ndryshuar në 4 (katër) vjet burgim.

Aktgjykimi i lëshuar nga Gjykata Themelore në lidhje me të pandehurit V [REDACTED] J [REDACTED] S [REDACTED] J [REDACTED] G [REDACTED] X [REDACTED] dhe E [REDACTED] M [REDACTED] është ndryshuar *ex officio* si në vijim:

I pandehuri V [REDACTED] J [REDACTED] është shpallur fajtor

për kryerje të terrorizmit në kundërshtim të nenit 136 (1) lidhur me nenin 135 (1.10) të KPRK-së, sepse ai, në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një grup terrorist të vetëquajtur të njohur si "Lëvizja e Lirisë", me qëllim të detyrimit të padrejtë të Qeverisë së Republikës së Serbisë të ndërpresë aktivitetet e saj policore në rajonin e Bujanocit, padrejtësisht të detyrojë anëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të lënë vendin e tyre të punës dhe



padrejtësisht të detyrojë "bashkësinë ndërkombëtare" për të vendosur forcat paqeruajtëse në rajon;


- në bashkëkryerje ka marrë në posedim dhe në kontroll një numër të pacaktuar të armëve (duke përfshirë pushkë, mitraloz, dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist "Lëvizja e Lirisë", në bashkëkryerje me të pandehurit G [REDACTED] X [REDACTED] G [REDACTED] L [REDACTED] S [REDACTED] J [REDACTED] A [REDACTED] Z [REDACTED] E [REDACTED] M [REDACTED] S [REDACTED] S [REDACTED] M [REDACTED] A [REDACTED] Q [REDACTED] R [REDACTED] në një vend të pacaktuar, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 01 korrik 2012;

për organizim të grupit terrorist, neni 113 (1) i KPK-së, sepse ai ka organizuar dhe drejtuar një grup terrorist të vetëquajtur të njohur si "Lëvizja e Lirisë", duke siguruar armatim, uniforma dhe mjete të tjera të nevojshme për aktivitetet e grupit, duke vendosur se cilat aktivitete do të kryhen nga grupi, duke vendosur se kur, ku dhe nga kush duhet të kryhen aktivitetet e tilla, personalisht duke marrë pjesë në të paktën një prej sulmeve të kryera nga grupi, siç është përshkruar më lart, duke përgatitur objektivat politike të grupit, duke përfshirë marrjen e përgjegjësisë për sulmet e kryera nga grupi. Këto veprime kanë ndodhur në një vend të pacaktuar, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 1 korrik 2012;

për këto arsye, i pandehuri V [REDACTED] J [REDACTED] është dënua për veprën penale të përshkruar në pikën një: kryerje të terrorizmit nga neni 136 (1) në lidhje me nenin 135 (1.10) të KPRK-së me 5 (pesë) vjet burgim; për veprën penale të përshkruar në pikën dy: organizim të grupit terrorist nga neni 113 (1) i KPK-së me 7 (shtatë) vjet burgim dhe me gjobë prej 1000 (njëmijë) eurosh sipas nenit 39 (1) dhe (2) të KPK-së që duhet të paguhet jo më vonë se 3 (tre) muaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë. Në bazë të nenit 71 (1) (2) pikës 2 të KPK-së ndaj të pandehurit është shqiptuar dënimi unik me 8 vjet burgim. Koha e kaluar në paraburgim do t'i llogaritet në dënim në përputhje me nenin 365 (1) 5) të KPPK-së; i pandehuri lirohet nga obligimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, në përputhje me nenin 453 (4) të KPPK-së.

S [REDACTED] është shpallur fajtor

për kryerje të terrorizmit në kundërshtim të nenit 136 (1) lidhur me nenin 135 (1.10) të KPRK-së, sepse ai, në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një grup terrorist të vetëquajtur të njohur si "Lëvizja e Lirisë", me qëllim të detyrimit të padrejtë të Qeverisë së Republikës së Serbisë të ndërpresë aktivitetet e saj policore në rajonin e Bujanocit, padrejtësisht të detyrojë



anëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të lënë vendin e tyre të punës, dhe padrejtësisht të detyrojnë "bashkësinë ndërkombëtare" për të vendosur forcat paqeruajtëse në rajon;

- ka marrë paligjshëm në posedim dhe në kontroll një numër të pacaktuar të armëve (duke përfshirë pushkë, mitraloz, dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist "Lëvizja e Lirisë", në bashkëkryerje me të pandehurit V [redacted], E [redacted], M [redacted], G [redacted], L [redacted], A [redacted], Z [redacted], G [redacted], X [redacted], S [redacted], S [redacted], M [redacted], A [redacted], Q [redacted], R [redacted] në një vend të pacaktuar, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 16 tetor 2012.

Për pjesëmarrje në grup terrorist, në kundërshtim të nenit 113 paragrafit 3 të KPK-së, sepse është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ai, në bashkëkryerje me V [redacted], E [redacted], M [redacted], G [redacted], L [redacted], A [redacted], Z [redacted], G [redacted], X [redacted], S [redacted], S [redacted], M [redacted], A [redacted] dhe Q [redacted], R [redacted], kanë marrë pjesë aktive në grup terrorist të vetëquajtur të njohur si "Lëvizja e Lirisë duke marrë përgjegjësitë, duke kërkuar armatim, duke kryer veprat penale të përshkruara më lart dhe duke vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimet e grupit. Këto veprime kanë ndodhur në një vend të pacaktuar, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 6 tetor 2012.

Për këto arsye, i pandehuri S [redacted], J [redacted] është dënuar për veprën penale të përshkruar në pikën një: kryerje të terrorizmit nga neni 136 (1) në lidhje me nenin 135 (1.10) të KPRK-së me 5 (pesë) vjet burgim; për veprën penale të përshkruar në pikën dy: pjesëmarrje në grup terrorist nga neni 113 (1) i KPK-së me 4 (katër) vjet burgim. Në bazë të nenit 71 (1) (2) pikës 2 të KPK-së ndaj të pandehurit është shqiptuar dënimi unik me 6 (gjashtë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim. Koha e kaluar në paraburgim do t'i llogaritet në dënim; i pandehuri lirohet nga obligimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, në përputhje me nenin 453 (4) të KPPK-së.

G [redacted], X [redacted] është shpallur fajtor

për kryerje të terrorizmit në kundërshtim të nenit 136 (1) lidhur me nenin 135 (1.10) të KPRK-së, sepse ai, në bashkëkryerje me pjesëmarrës të tjerë në një grup terrorist të vetëquajtur të njohur si "Lëvizja e Lirisë", me qëllim të detyrimit të padrejtë të Qeverisë së Republikës së Serbisë të ndërpresë aktivitetet e saj policore në rajonin e Bujanocit, padrejtësisht të detyrojnë anëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të lënë vendin e tyre të punës, dhe



padrejtësisht të detyrojë "bashkësinë ndërkombëtare" për të vendosur forcat paqeruajtëse në rajon;

- ka marrë paligjshëm në posedim dhe në kontroll një numër të pacaktuar të armëve (duke përfshirë pushkë, mitraloz, dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist "Lëvizja e Lirisë", në bashkëkryerje me të pandehurit V [redacted] J [redacted] S [redacted] J [redacted], G [redacted] L [redacted], A [redacted] Z [redacted], E [redacted] M [redacted] S [redacted] S [redacted] M [redacted] A [redacted] Q [redacted] R [redacted] në një vend të pacaktuar, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 1 korrik 2012;


Për pjesëmarrje në grup terrorist, në kundërshtim të nenit 113 paragrafit 3 të KPK-së, sepse është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ai, në bashkëkryerje me V [redacted] J [redacted], S [redacted] J [redacted], G [redacted] L [redacted], A [redacted] Z [redacted], E [redacted] M [redacted] S [redacted] S [redacted] M [redacted] A [redacted] Q [redacted] R [redacted], kanë marrë pjesë aktive në grup terrorist të vetëquajtur të njohur si "Lëvizja e Lirisë, duke kërkuar armatim, duke kryer veprat penale të përshkruara më lart dhe duke vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për veprimet e grupit, në një vend të pacaktuar, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 1 korrik 2012;

Për këto arsye, i pandehuri G [redacted] X [redacted] është dënuar për veprën penale të përshkruar në pikën një: kryerje të terrorizmit nga neni 136 (1) në lidhje me nenin 135 (1.10) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës me 5 (pesë) vjet burgim; për veprën penale të përshkruar në pikën dy: pjesëmarrje në grup terrorist nga neni 113 (1) i KPK-së me 2 (dy) vjet burgim; në bazë të nenit 71 (1) (2) pikës 2 të KPK-së ndaj të pandehurit është shqiptuar dënimi unik me 5 (pesë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim. Koha e kaluar në paraburgim do t'i llogaritet në dënim; i pandehuri lirohet nga obligimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, në përputhje me nenin 453 (4) të KPPK-së.

Aktgjykimi i lëshuar nga Gjykata Themelore e Gjilanit në lidhje me të pandehurit G [redacted] L [redacted], M [redacted] A [redacted] S [redacted] S [redacted] A [redacted] Z [redacted] dhe J [redacted] S [redacted] është vërtetuar në tërësi.

Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë

5. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit janë paraqitur nga avokati mbrojtës: M [redacted] M [redacted] në emër të të akuzuarit M [redacted] A [redacted] (14 gusht 2015), D [redacted] R [redacted] në emër të të akuzuarit S [redacted] S [redacted] (24 gusht 2015), dhe S [redacted] P [redacted] në emër të të akuzuarit G [redacted] L [redacted] (14 tetor 2015), dhe nga vetë të akuzuarit: V [redacted] J [redacted] (13 gusht 2015), S [redacted] J [redacted] (18 gusht 2015), dhe G [redacted] X [redacted] (31 gusht 2015).



6. Prokurori i Shtetit ka paraqitur mendimin mbi kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës t'i refuzojë ato si të pabazuara. Prokurori pohon se kërkesat nuk kanë arritur ta vërtetojnë asnjë gabim në aktgjykimet e kundërshtuara që do të jepte të drejtë për anulimin apo ndryshimin e aktgjykimeve të kundërshtuara. Prokurori më tutje parashton se gabimet e pretenduara të theksuara nga avokatët mbrojtës apo të pandehurit nuk cilësohen si shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale me peshë të paragjykimin ndaj të drejtës së të akuzuarve për gjykim të drejtë.

II. Parashtrësit e palëve

Mbrojtësi i G [REDACTED]

7. Avokati Mbrojtës për G [REDACTED] L [REDACTED] bazon kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në shkeljen e kodit penal dhe shkeljen e kodit të procedurës penale. Ai propozon anulimin e aktgjykimeve të kundërshtuara dhe dërgimin e çështjes në rigjykim.

8. Shkelja e Kodit të Procedurës Penale:

- Neni 384 (1.12) i KPPK-së, sepse dispozitivi është i pa qartë, jo i kuptueshëm dhe kundërthënës në përmbajtjen dhe arsyetimin e tij dhe nuk përbënë arsyet lidhur me faktet vendimtare dhe ato të paraqitura janë plotësisht të pa qarta.

9. Shkelja e Kodit Penal:

- elementet subjektive dhe objektive për veprat penale të kryera nuk janë përmbushur; gjykata shkallës së parë ka dështuar të merr parasysh nenin 31 të KPK-së kur ka gjetur se i pandehuri ka kryer në bashkëpunim veprën penale derisa nuk ka të dhëna që e mbështesin këtë përfundim, në shkelje të nenit 385 (1), 1.4 të KPPK-së.

10. Analiza e përmbajtjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë shpie në përfundimin që mbrojtja mbështetet po ashtu edhe në bazën e vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike. Në këtë kontekst, ai thekson që deklaratat e dëshmitarëve janë diametralisht kundërthënëse dhe nuk i referohen veprimeve të cilat mund të konsiderohen që e inkriminojnë të pandehurin G [REDACTED] L [REDACTED]. Nuk ka prova që ai ka marr pjesë në ekspeditat e stilit ushtarak të datës 14 dhe 15 qershor 2012.

Mbrojtësi i M [REDACTED] A [REDACTED]



11. Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë bazohet në shkeljen e Kodit të Procedurës Penale, zbatimin e gabuar të Kodit Penal dhe vendimit të paarsyetuar lidhur me sanksionin penal. Mbrojtësi propozon ndryshimin e aktgjyqimeve të kundërshtuara dhe lirim të pandehurit ose anulimin e aktgjyqimeve dhe dërgimin e çështjes në rigjykim.

12. Shkelja e Kodit të Procedurës Penale:

- Nenit 384 (1.12) dhe (2) në lidhje me Nenin 369 (1) dhe 370 (7) të KPPK-së, sepse sipas tij, dispozitivi është i paqartë, i pa kuptueshëm, kundërtë në përmbajtjen dhe arsyetimin e tij dhe se nuk ka arsye lidhur me faktet vendimtare kurse ato të paraqitura janë plotësisht të paqarta;
- Nenit 269 (1) të KPPK-së sepse aktgjykimi ishte përpiluar 75 ditë pas afatit dhe ky argument nuk ishte shqyrtuar nga Gjykata e Apelit.

13. Shkelja e Kodit Penal:

- Nenit 113 të KPK-së i cili thekson që vepra penale e terrorizmit mund të kryhet vetëm me pjesëmarrje aktive.

14. Mbrojtja po ashtu ngrit argumentet kundër aktgjykimit të cilat bien në kategorinë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Sipas mbrojtjes nuk ka prova që mbështesin përfundimet e arritura në aktgjykimet e kundërshtuara të gjykatave të të dy instancave. Më tej, mbrojtja thekson që qëllimi dhe elementet tjera të veprës penale nuk janë vërtetuar.

15. Për më tepër, mbrojtja e konteston dënimin që i caktuar të pandehurit. Sipas mbrojtjes, vendimi mbi dënimin është shumë i ashpër dhe në kundërshtim me ligjin. Mbrojtja thekson që gjykata ka dështuar të merr parasysh sjelljen e të pandehurit në gjykatë dhe situatën familjare të tij.

Mbrojtësi i S [REDACTED] S [REDACTED]

16. Thekson shkeljet esenciale dhe shkeljet tjera të procedurës penale dhe shkeljet e kodit penal. Ai propozon lirim nga akuzat ose anulimin e aktgjyqimeve të kundërshtuara dhe dërgimin e çështjes në rigjykim.


17. Shkeljet e Kodit të Procedurës Penale:



- Neni 370 (7) i KPPK-së sepse aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me ligjin ngase bazat e aktgjykimit nuk janë sqaruar, në veçanti, nuk ka vlerësim të provave kontradiktore. Për më tepër, nuk ka arsyetim përse kërkesa për ta thirrur një dëshmitare ekspert lidhur me autencitetin e fotografive, përkatësisht lidhur me kohën dhe vendin ku janë bërë fotografitë, ishte refuzuar.
- Neni 222 i KPPK-së sepse prokurori nuk ka mundur të paraqes aktakuzën me të cilën e ngarkon të pandehurin me vepra të tjera penale të cilat nuk kanë qenë objekt i hetimeve. Gjatë hetimeve, i pandehuri ishte marr në pyetje lidhur me veprën penale të terrorizmit; ai është dëgjuar vetëm lidhur me pjesëmarrjen në grupin terrorist dhe për armëmbajtje. Nuk ka vendim të hetimeve lidhur me këto dy vepra penale; prokurori nuk ka mundur të paraqes aktakuzë për vepra tjera penale si në pikën 1 të aktakuzës kundër S [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] sepse për atë vepër penale hetimet nuk janë zhvilluar fare.
- Neni 6 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, dhe neni 30 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garantojnë të drejtën e të pandehurit për t'u njoftuar menjëherë lidhur me akuzat me të cilat ngarkohet ai.
- Neni 384 (2) i KPPK-së sepse i pandehuri nuk ishte njoftuar gjatë hetimeve lidhur me akuzat me të cilat ngarkohej derisa kishte pranuar aktakuzën, e cila përmban shkelje.

18. Shkeljet e Kodit Penal

- Neni 135 (1.10) dhe neni 136 i KPK-së sepse është pranuar që kjo vepër penale mund të kryhet vetëm thjesht duke mbajtur armë;
 - Neni 113 (3) i KPK-së ose neni 143 par 2 i KPRK-së për kryerjen e veprës penale kërkohet pjesëmarrje aktive në grupin terrorist. Çfarëdo pjesëmarrje nëse nuk është aktive nuk përmbush elementet e kësaj vepre penale;
 - Ligji mbi Amnistinë 04/L-209 jep amnistinë për veprat penale nga neni 328 i KPK-së, përkatësisht nga neni 374 të KPRK-së. Kështu, mbrojtja thekson, që vepra themelore përmes së cilës pretendohet kryerja e veprës penale të terrorizmit është e përfshirë në amnisti, prandaj ndjekja penale për veprën penale të terrorizmit as nuk mund të zhvillohet.
19. Sikurse avokatët tjerë, avokati i S [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] thekson vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Sipas mbrojtësit, elementet e veprës penale për të cilën i pandehuri është



dënuar nuk janë provuar me asnjë provë. Avokati thekson që në rastin e S [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] nuk ka prova që tregojnë që ai ishte anëtarë aktiv në grupin e armatosur terrorist. Për më tepër, ai thekson që e vetmja provë inkriminuese ndaj tij janë tri fotografi me armë që janë bërë në një vend i cili nuk është përcaktuar. Mbrojtësi, më tutje, thekson që dashja direkte e të pandehurit për të kryer veprat penale nuk është vërtetuar. Sipas mbrojtësit, gjykata thjesht është mbështetur në tre fotografi dhe ka cituar disa shkrime nga ditari elektronik nga kompjuteri i V [REDAKTUAR] dhe S [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR] ose disa biseda telefonike me V [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR] që nuk janë të qarta. Këto fakte, si lloji i armës, numri serik, viti i prodhimit, çfarë marke, kalibri etj., nuk janë vërtetuar. Mbrojtësi pretendon që përfundimi që qëllimi i S [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] ishte të detyrojë qeverinë e Serbisë të ndërpresë aksionet policore në pjesën e Bujanovcit, të detyrojë pjesëtarët e Policisë Serbe të nacionalitetit Shqiptar të lëshojnë vendet e tyre të punës ose të detyrojë komunitetin ndërkombëtarë të vendos forca paqeruajtëse në regjion, ishte i gabuar.

V [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR]

20. I akuzuari në kërkesë thekson zbatimin e gabuar të Kodit të Procedurës Penale, nga neni 432 par 1 pikat 1.1, 1.2 1.3 të KPPK-së, shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par 1 i KPPK-së, dhe shkeljen e dispozitave të Kodit Penal.
21. Shkeljet e Kodit të Procedurës Penale:
 - Neni 384 (1.8) të KPPK-së duke pretenduar që aktgjykimi është bazuar në provë të papranueshme. Në veçanti, ai thekson që provat në të cilat mbështeten gjykatat ishin marr në banesën e vëllait të tij derisa ai ka jetuar në Hotelin Fontana. Ai thekson që kontrolli në fakt ishte zhvilluar pa urdhër të gjykatës në shkelje të nenit 249 dhe nenit 111 par 1 të KPPK-së;
 - Neni 155 dhe neni 257 par 4 nën-par. (4.1) të KPPK-së sepse marrja e tij në pyetje nga ana e prokurorit ka shkelur liritë e tij duke përdorur lodhjen e tij.
22. Shkeljet e Kodit Penal:
 - Sipas të akuzuarit, elementet ligjore të veprës penale për të cilën është dënuar nuk janë përmbushur.
23. Për më tepër, i akuzuari thekson që prokurori përgjegjës për hetimin e këtij rasti ka ndryshuar deklaratën e tij të dhënë gjatë hetimit.



S [REDACTED] J [REDACTED]


24. I Akuzuari ka dorëzuar një kërkesë të unifikuar e cila përmban kërkesa për tre mjete ligjore: për mbrojtje të ligjshmërisë, ri-shqyrtim të procedurës penale dhe për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit. Në pjesën e cila mund të klasifikohet si kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ai kërkon refuzimin e akuzave ndaj tij, të shqyrtohen dhe ndryshohen aktgjykimet e kundërshtuara. Ai thekson se gjykatat e të dy instancave kanë shkelur dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe të Kodit Penal.
25. Shkelja e Kodit të Procedurës Penale:
- Neni 423 (1.1) i KPPK-së sepse aktgjykimet e lëshuara nga gjykatësit e Gjykatës Themelore dhe të asaj të Apelit ishin në ndikimin e Serbisë. Ai thekson që ka kërkuar përjashtimin e një gjykatëse të EULEX-it nga paneli sipas nenit 39 dhe jo atij 40 të KPPK-së siç theksohet në aktgjykim;
 - Ligjit mbi ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që lidhen me Mandatin e Misionit për Sundim të Ligjit të Bashkimit Evropian në Republikën e Kosovës (03/L-273) sepse përbërja e panelit nuk ishte në pajtim me ligjin. Ai pretendon jo kushtetutshmërinë e Marrëveshjes së lidhur në mes të Shefit të EULEX-it dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 18 qershor 2014;
 - Neni 314 (1.2) i KPPK-së i cili parasheh përfundimin e gjyqimit brenda 120 ditësh derisa në këtë rast gjykimi ka zgjatur një vit;
 - Neni 369 (1) i KPPK-së sepse aktgjykimi i shkruar është vonuar nga data 14 tetor deri më 27 janar 2014;
 - Neni 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht parimi ne bis in idem, sepse ai është akuzuar për të njëjtat vepra penale për të cilat ai është ndjekur penalisht edhe nga autoritetet në Serbi;
 - Neni 262 i KPPK-së sepse nuk ka asnjë provë të vetme materiale, fakt ose deklaratë e cila mbështet një aktgjykim fajësues, çka do të duhej konsideruar si bazë për gjetje jo të plotë dhe të gabuara të fakteve.



26. Në kërkesën e tij, S [REDACTED] J [REDACTED] thekson shumë shkelje të procedurës penale të cilat pretendon se i kanë bërë gjykatat e dy instancave por ai nuk specifikon saktësisht dispozitat ligjore të shkelura. Analiza e kërkesës së tij shpie në përfundim se ai konteston si në vijim:

- Kompetencën e prokurorit për të zhvilluar aktivitetet prokuroriale në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe për të ndjekur veprat penale të cilat janë kryer në territorin e një shteti tjetër-si këto që kanë ndodhur në Prëshevë-Serbi;
- Koha kur është dorëzuar aktakuza sepse nuk është dorëzuar brenda 8 muajve kur një person është në paraburgim;
- Prokurori nuk iu ka dhënë të akuzuarave një kopje të materialit të prokurorisë për t'u mundësuar atyre një përgatitje efektive për gjykim;
- Gjykata nuk ka respektuar afatet p.sh., dëgjimi i dytë është mbajtur pas 45 ditësh dhe jo brenda 40 ditësh siç kërkohet me ligj;
- Gjykimi nuk ishte publik sepse nuk ishte publik edhe për media;
- Ai ishte i privuar nga e drejta për mbrojtje efektive nga avokati mbrojtës sepse avokati i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare nuk i ka dhënë atij asgjë ndihmë juridike;
- Deklarata e tij e 19 shkurtit 2013 nuk i ishte lexuar atij plotësisht në gjuhën Shqipe, dhe i ishte përkthyer vetëm pjesërisht nga përkthyesi dhe ai kishte nënshkruar vetëm versionin në Anglisht;
- Kontrolli ishte bërë pa urdhër të gjykatës;
- Parashtrësat e tij nuk ishin shqyrtuar p.sh., fjala përfundimtare e cila përmbante rreth 20 faqe, e dorëzuar me datën 14 tetor 2013 dhe në të njëjtën ditë gjykata kishte zhvilluar seancën e këshillimit dhe votimit. Ai thekson se ishte e pamundshme që fjala e tij përfundimtare të ishte e përkthyer dhe shqyrtuar nga paneli në të njëjtën ditë;
- Ai nuk ishte lejuar të flasë në gjykim rreth terrorit të Serbisë kundër atij, familjes dhe njerëzve të tij dhe të prezantojë faktet që ishin në favor të tij;
- Aktgjykimi final është i bazuar në deklarata false dhe të pavërteta të ekspertëve dhe përkthyesve dhe në pjesë të provave që janë të papranueshme.

27. Shkeljet e Kodit Penal:



- Neni 135 i KPRK-së sepse nuk ka prova për ekzistencën e grupit terrorist, asnjë provë që vërteton krijimin dhe strukturën e grupit, kohëzgjatjen dhe për më tepër ekzistencën e qëllimit të bashkëveprimit. Ai më tutje thekson që qëllimi ishte të ndalej terrori shtetëror dhe jo të kryheshin krime. Ai paraqet që veprat penale për të cilat akuzohet kanë të bëjnë me vetëmbrojtjen dhe prandaj nuk mund të kualifikohen si terrorizëm;
 - Ai pretendon kualifikimin e gabuar të veprave penale sepse ai nuk është akuzuar nga prokurori për sulm dhe shkaktim të rënda të lëndimeve trupore. Ai thekson që qëllimi për kryerjen e veprës penale të terrorizmit nuk është vërtetuar sepse luftëtarët e Bujanovcit kanë publikuar Deklaratën e cila apelon për ndalje të terrorit shtetëror dhe jo ashtu sikurse është falsifikuar nga ana e prokurorit për të ndërprerë aktivitetet policore në regjionin e Bujanovcit;
 - Ai thekson që neni 109 i Kodit të vjetër Penal të Kosovës nuk e parasheh veprën e sulmit dhe lëndimet e lehta trupore siç ndodhë me nenin 135.1.3 të KPRK-së. Duke marr parasysh kohën materiale, kodi i vjetër ishte në fuqi, atëherë, i akuzuari pretendon që ai nuk mund të akuzohet për sulm dhe shkaktim të lehtë të lëndimeve trupore në bazë të nenit 136 të KPRK-së sepse ky nuk ishte në fuqi në atë kohë.
28. Pjesa më e madhe e kërkesës së dorëzuar nga S [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR] përmban argumente kundër gjetjeve faktike të gjykatave të të dy instancave. Sipas tij, faktet ishin vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë dhe ato nuk kanë mbështetje në provat e prezantuara gjatë shqyrtimit gjyqësor.


G [REDAKTUAR] X [REDAKTUAR]

29. I akuzuari thekson që Gjykata e Apelit nuk ka shqyrtuar të gjitha shkeljet të cilat ai i ka parashtruar në ankesën e tij. Aktgjykimi i Gjykatës së instancës së parë ishte i padrejtë dhe Gjykata e Apelit nuk ka adresuar shkeljet e Kodeve materiale dhe procedurale as ato lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Përbërja e kolegjit

30. Kolegji i gjykatës Supreme ishte përbërë në përputhje me nenin 21 (6) të *Ligjit për Gjykatat* (Ligji Nr. 03/L-199), dhe nenin 3 të *Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë* (Ligji nr. 03/L-053) i ndryshuar me



Ligjin nr. 04/L-273 (të njohur si *Ligji Omnibus*, të cilit tani e tutje i referohemi kësisoj), dhe të qartësuar me anë të *Marrëveshjes në mes të Shefit të Misionit të EULEX-it Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës* të datës 18 qershor 2014.

31. Neni 1.A. i *Ligjit Omnibus* parashikon juridiksionin e gjyqtarëve të EULEX-it në dy lloje të rasteve që janë në proces. Një rast në proces, për qëllime të këtij ligji, do të thotë:
- Rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është lëshuar para 15 prillit 2014 nga prokurorët e EULEX-it, në përputhje me ligjin,
 - Rastet që janë caktuar te gjyqtarët e EULEX-it para 15 prill 2014.
32. Kolegji thekson se rasti i tanishëm është në kompetencë të gjyqtarëve të EULEX-it pasi që hetimi në këtë rast ka filluar para 15 prill 2014.
33. Sa i përket përbërjes së kolegjeve, neni 3.2 i Ligjit Omnibus thotë: "*Kolegjet në të cilat gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë juridiksionin e tyre në procedurat penale do të përbëhen me shumicë të gjyqtarëve të vendorë dhe do të kryesohen nga një gjyqtar vendor*". Megjithatë, kjo dispozitë nuk përcakton në cilin nga dy llojet e rasteve në proces do të zbatohen, d.m.th rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është lëshuar para 15 prill 2014 nga prokurorët e EULEX-it, në përputhje me ligjin dhe / ose për rastet që caktohen te gjyqtarët e EULEX-it para 15 prill 2014.
34. Sipas mendimit të kolegjit, neni 3.2 i Ligjit Omnibus eventualisht mund të jetë i zbatueshëm për rastet sipas nenit 1.A. par 1, respektivisht, për të cilat është paraqitur vendimi për fillimin e hetimeve para 15 prillit 2014 nga prokurorët e EULEX-it në pajtim me ligjin. Kjo do të thotë, në qoftë se vendimi për fillimin e hetimeve është paraqitur para 15 prillit 2014, por hetimi është përfunduar dhe Aktakuza është ngritur pas hyrjes në fuqi të Ligjit Omnibus, atëherë në këtë rast dispozitat e Ligjit Omnibus mund të jenë të zbatueshme në lidhje me përbërjen e trupit gjykues.
35. Situata është e ndryshme për rastet tashmë të caktuara gjyqtarëve të EULEX-it para 15 prillit 2014, para hyrjes në fuqi të *Ligjit Omnibus*, në përputhje me nenin 1.A. par 2. Në këtë situatë, nëse një rast është caktuar për gjyqtarë të EULEX-it para 15 prillit 2014 atëherë rasti do të vazhdojë të trajtohet nga gjyqtarët e EULEX-it, në përputhje me ligjin që ishte në fuqi në kohën kur rasti është caktuar te gjyqtarëve të EULEX-it. Ndryshimet pasuese në ligj, siç ka ndodhur këtu me hyrjen në fuqi të *Ligjit Omnibus*, sipas mendimit të Panelit, nuk mund të kenë fuqi prapavepruese për përbërjen e trupit gjykues, pavarësisht nga faza e procedurës.

Pranueshmëria e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë



36. Kolegji konstatoi se të gjitha kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të pranueshme. Ato janë paraqitur nga persona të autorizuar (neni 433 (1) i KPP-së), në afatin e përcaktuar (neni 433 (2) i KPP-së), dhe në gjykatën kompetente (neni 434 (1) i KPP-së).
37. Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë në seancën e kolegjit, siç parashihet me nenin 435 (1) të KPP-së. Njoftimi palëve për seancën nuk ishte i nevojshëm.

Gjetjet për meritat e lëndës

Fusha e vlerësimit:

38. Kolegji do të kufizojë analizën e tij vetëm për shkeljet të cilat mund të përbëjnë bazën për të paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, siç përshkruhet në nenin 432 (1) të KPP-së. Prandaj, pretendimi se aktgjykimet janë bazuar në gjetjet faktike të gabuara ose të paplota nuk do të merret parasysh, pasi në përputhje me nenin 432 (3) të KPP-së kjo nuk mund të jetë bazë për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Shkelje të Nenit 384 (1.12) në lidhje me nenin 370 të KPP-së

39. Analiza e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitura nga të gjithë avokatët mbrojtës dhe nga i akuzuari S [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR] çon në një përfundim se shkeljet e pretenduara esenciale të procedurës penale të kryera nga gjykatat e të dyja instancave i referohen faktit se aktgjykimet nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 384 (1.12) në lidhje me nenin 370 të KPP-së. Ky argument në lidhje me aktgjykimin e Gjykatës Themelore tashmë ishte vlerësuar nga Gjykata e Apelit, dhe është refuzuar si e pabazuar. Kërkuesit në parashtrësit e tyre kanë përsëritur argumentet kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë, si dhe kanë ngritur të njëjtat argumente kundër vendimit të Gjykatës së Apelit.
40. Gjykata Supreme ka shqyrtuar tërësisht aktgjykimet e të dyja shkallëve që duhet të lexohen në lidhje me njëra tjetrën, pasi vendimi i shkallës së dytë i referohet drejtpërdrejt vendimit të lëshuar nga gjykata e shkallës së parë. Analiza e këtyre dokumenteve të çon në përfundimin se të dy aktgjykimet nuk i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 384 (1.12) në lidhje me nenin 370 të KPP-së. Ato nuk janë në përputhje dhe të kuptueshme, dhe nuk është e qartë se cilat fakte janë vërtetuar nga të dy gjykatat për të konkluduar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat ishin akuzuar.



41. Siç rezulton nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Gjilanit, të akuzuarit V [redacted] J [redacted] G [redacted] L [redacted], G [redacted] X [redacted], S [redacted] J [redacted], A [redacted] Z [redacted], E [redacted] M [redacted] S [redacted] S [redacted], M [redacted] A [redacted] dhe Q [redacted] R [redacted] ishin duke vepruar në bashkëkryerje në një grup terrorist të vetëquajtur të njohur si "Lëvizja e Lirisë", me qëllim të detyrimit të padrejtë të Qeverisë së Republikës së Serbisë të ndërpresë aktivitetet e saj policore në rajonin e Bujanocit, padrejtësisht të detyrojë anëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të lënë vendin e tyre të punës, dhe padrejtësisht të detyrojë "bashkësinë ndërkombëtare" për të vendosur forcat paqeruajtëse në rajon.

Aktet e terrorizmit janë kryer në mënyrën si në vijim:

- Më 28 qershor 2012, në rreth orës 4.00 në Dobrosin (Komuna e Gjilanit), V [redacted] J [redacted], G [redacted] X [redacted] dhe E [redacted] M [redacted] morën pjesë në një sulm duke dëmtuar kontejnerin e Policisë Kufitare të Serbisë të vendosur në Bujanoc dhe duke shkaktuar lëndime të lehta trupore Policit Serb B [redacted] M [redacted] duke qëlluar me armë të ndryshme, të gjitha të poseduara dhe të përdoruara në mënyrë të paligjshme, një numër të pacaktuar të fishekëve të kalibrit me ndryshëm (më shumë se 100);
- Më 07 tetor 2012, në rreth orës 21.35 në Dobrosin (Komuna e Gjilanit), S [redacted] J [redacted] dhe E [redacted] M [redacted] me një numër të paidentifikuar të kryerësve të tjerë morën pjesë në një sulm duke dëmtuar kontejnerin e Policisë Kufitare të Serbisë të vendosur në Bujanoc, duke qëlluar me armë të ndryshme, të gjitha të poseduara dhe të përdoruara në mënyrë të paligjshme, një numër të papërcaktuar të fishekëve me kalibrit të ndryshëm;
- Duke filluar më së largu nga prilli 2012 deri më 1 korrik 2012 V [redacted] J [redacted], G [redacted] X [redacted], Q [redacted] R [redacted] dhe M [redacted] A [redacted] deri më 16 tetor 2012 S [redacted] J [redacted] S [redacted] S [redacted] dhe E [redacted] M [redacted] deri më 17 tetor 2012 A [redacted] Z [redacted] dhe deri më 13 shkurt 2013 G [redacted] L [redacted], në bashkëkryerje kanë marrë në posedim dhe në kontroll në numër të pacaktuar të armëve (duke përfshirë pushkë, mitraloz, dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist "Lëvizja e Lirisë".

V [redacted] J [redacted], duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 01 korrik të vitit 2012, ka organizuar dhe drejtuar një grup terrorist të vetëquajtur njohur si "Lëvizja e Lirisë", duke siguruar armatim, uniforma dhe mjete të tjera të nevojshme për aktivitetet e grupit, duke vendosur se cilat aktivitete do të kryhen nga grupi, duke vendosur se kur, ku dhe nga kush duhet të kryhen aktivitetet e tilla, personalisht duke marrë pjesë në të paktën një prej sulmeve të kryera nga grupi,

duke përgatitur objektivat politike të grupit, duke përfshirë marrjen e përgjegjësisë për sulmet e kryera nga grupi.

Duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 1 korrik 2012 G [REDACTED] X [REDACTED] Q [REDACTED] R [REDACTED] dhe M [REDACTED] A [REDACTED] deri më 16 tetor 2012 S [REDACTED] J [REDACTED] S [REDACTED] S [REDACTED] dhe E [REDACTED] M [REDACTED] deri më 17 tetor 2012, A [REDACTED] Z [REDACTED], dhe deri më 13 shkurt 2013 G [REDACTED] L [REDACTED], në një vend të papërcaktuar të Kosovës, ata kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në bashkëkryerje në një grup terrorist të vetëquajtur dhe të njohur si "Lëvizja e Lirisë". S [REDACTED] J [REDACTED]⁴, G [REDACTED] X [REDACTED]⁵, E [REDACTED] M [REDACTED]⁶ kanë marrë pjesë në të, duke hartuar kërkesat e përgjegjësisive, duke kërkuar për armatim, me çka kanë kryer veprat penale të përshkuara më lart, dhe përndryshe duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij. G [REDACTED] L [REDACTED], Q [REDACTED] R [REDACTED], M [REDACTED] A [REDACTED], S [REDACTED] S [REDACTED]¹⁰ dhe A [REDACTED] Z [REDACTED]¹¹ kanë vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij. Në rastin e këtyre pesë të akuzuarve, Gjykata Themelore ka vërtetuar gjithashtu se grupi terrorist në të cilin kanë marrë pjesë ka kryer sulmet ndaj instalimeve të policisë serbe, më 17 maj, 28 qershor dhe 07 tetor 2012.

V [REDACTED] J [REDACTED] i shpallur fajtor për organizimin e grupit, është përmendur edhe si pjesëmarrës i grupit¹².

42. Në vendimin e saj, Gjykata e Apelit theksoi se vlerësimi i provave i kryer nga Gjykata Themelore u pranua. Pavarësisht kësaj, aktgjykimi i shkallës së parë ishte ndryshuar *ex officio* modifikuar në pjesën e gjetjeve faktike, çka rezultoi më tej në zbutjen e dënimit të shqiptuar ndaj disa të akuzuarve.

43. Gjykata e Apelit ka hequr disa veprime të caktuara nga sjellja kriminale që i atribuoheshin të akuzuarve në vijim:

- V [REDACTED] J [REDACTED] dhe G [REDACTED] X [REDACTED] – Pjesëmarrja në sulm më 28 qershor 2012 rreth orës 04.00 ;
- S [REDACTED] J [REDACTED] - Pjesëmarrja në sulm më 07 tetor 2012 rreth orës 21.35;

⁴ F.5 e Aktgjykimi të Gjykatës Themelore

⁵ F.7

⁶ F.11

⁷ F.6

⁸ F.8

⁹ F.9

¹⁰ F.10

¹¹ F.12


¹² F.5



- E [REDACTED] M [REDACTED] – Pjesëmarrja në sulm më 28 qershor 2012 rreth orës 04.00, dhe më 07 tetor 2012 rreth orës 21.35.

Për më tepër, Gjykata e Apelit ka konstatuar se V [REDACTED] J [REDACTED], S [REDACTED] J [REDACTED] G [REDACTED] X [REDACTED] dhe E [REDACTED] M [REDACTED] duke vepruar në bashkëryerje me G [REDACTED] L [REDACTED], A [REDACTED] Z [REDACTED] S [REDACTED] S [REDACTED] M [REDACTED] A [REDACTED] dhe Q [REDACTED] R [REDACTED] në një grup terrorist të vetëquajtur e të njohur si "Lëvizja e Lirisë", me qëllim të detyrimit të padrejtë të Qeverisë së Republikës së Serbisë të ndërpresë aktivitetet e saj policore në rajonin e Bujanocit, padrejtësisht të detyrojë anëtarët e forcave të policisë serbe të kombësisë shqiptare të lënë vendin e tyre të punës, dhe padrejtësisht të detyrojë "bashkësinë ndërkombëtare" për të vendosur forcat paqeruajtëse në rajon, në mënyrë të paligjshme kanë marrë në posedim dhe në kontroll një numër të pacaktuar të armëve (duke përfshirë pushkë, mitraloz, dhe raketahedhës) të cilat ishin në dispozicion të grupit terrorist "Lëvizja e Lirisë". Këto aktivitete do të bëheshin në një vend të papërcaktuar, duke filluar më së voni nga prilli 2012 deri më 1 korrik 2012 në rastin e V [REDACTED] J [REDACTED] dhe G [REDACTED] X [REDACTED], deri më 16 tetor 2012 në rastin S [REDACTED] J [REDACTED] dhe E [REDACTED] M [REDACTED]

44. Me të njëjtin aktgjykim, Gjykata e Apelit ka vërtetuar në tërësi konstatimet faktike të bëra nga Gjykata Themelore në lidhje me të akuzuarit G [REDACTED] L [REDACTED], M [REDACTED] A [REDACTED], S [REDACTED] S [REDACTED] A [REDACTED] Z [REDACTED] dhe Q [REDACTED] R [REDACTED]. Si pasojë, me aktgjykim të formës së prerë është vërtetuar që këta të akuzuar, në bashkëryerje me persona të tjerë, duke vepruar me të njëjtin qëllim si V [REDACTED] J [REDACTED] S [REDACTED] J [REDACTED] G [REDACTED] X [REDACTED] dhe E [REDACTED] M [REDACTED] kanë marrë pjesë në një grup terrorist të vetëquajtur të njohur si "Lëvizja e Lirisë", e cila ka kryer sulmet ndaj instalimeve të policisë serbe më 17 maj, 28 qershor dhe 07 tetor 2012. Këto aktivitete u zhvilluan në një vend të papërcaktuar, duke filluar më së voni nga prilli 2012, deri më 1 korrik 2012 në rastin e Q [REDACTED] F [REDACTED] dhe M [REDACTED] A [REDACTED] deri më 16 tetor 2012, në rastin e S [REDACTED] S [REDACTED] deri më 17 tetor 2012, në rastin e A [REDACTED] Z [REDACTED] dhe deri më 13 shkurt 2013, në rastin e G [REDACTED] L [REDACTED].
45. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk përmban asnjë justifikim pse ishin ndryshuar gjetjet faktike të Gjykatës Themelore në lidhje me të akuzuarin V [REDACTED] J [REDACTED], S [REDACTED] J [REDACTED], G [REDACTED] X [REDACTED] dhe E [REDACTED] M [REDACTED]. Për më tepër, për shkak të këtij ndryshimi, gjykimi është bërë kontradiktor në brendësi, pasi në njërin anë disa ngjarje të lidhura me aktivitetet e "Lëvizjes së Lirisë" u eliminuan në lidhje me të akuzuarit e përmendur më sipër, dhe në anën tjetër aktgjykimi ishte vërtetuar plotësisht në lidhje me të akuzuarit G [REDACTED] L [REDACTED], M [REDACTED] A [REDACTED], S [REDACTED] S [REDACTED], A [REDACTED] Z [REDACTED] dhe Q [REDACTED] R [REDACTED] ku sulmet ndaj instalimeve të policisë serbe janë ende të përfshira në



përshkrimin e veprave penale që u atribuohen atyre. Prandaj, nuk është e qartë nëse sulmet ishin kryer fare nga ky grup.

46. Përveç kësaj, pavarësisht nga fakti se dispozitivi I aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nuk i lidhë të pandehurit për sulme të veçanta, në arsyetim lexohet: "nga provat është vërtetuar përtej dyshimit të ibrsyshëm se [REDACTED] J [REDACTED] G [REDACTED] X [REDACTED] dhe E [REDACTED] M [REDACTED] kanë kryer sulmin më 28 qershor 2012¹³". Më tej, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në pjesën e arsyetimit thekson se "'provat e konfiskuara, përkatësisht fotografitë konfirmojnë se i pandehuri S [REDACTED] J [REDACTED] me të pandehurit e tjerë morën pjesë në ekspedita të tjera më 18 mars, 28 prill, 1 dhe 6 maj 2012"¹⁴. Në mënyrë të ngjashme, në raport me G [REDACTED] X [REDACTED] Gjykata e Apelit thekson se është konstatuar se "ai ka marrë pjesë edhe në dy ekspedita të stilit ushtarak me V [REDACTED] J [REDACTED], S [REDACTED] J [REDACTED], Q [REDACTED] F [REDACTED], M [REDACTED] A [REDACTED] S [REDACTED] S [REDACTED] A [REDACTED] Z [REDACTED] dhe G [REDACTED] L [REDACTED] në 15 maj dhe 14 deri në 15 qershor 2012¹⁵."

47. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore gjithashtu nuk është i qartë. Dispozitivi dhe arsyetimi nuk e shpjegojnë në mënyrë shteruese cilat fakte janë vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Madje edhe një element i tillë themelor si periudha kur "Lëvizja e Lirisë" kishte vepruar nuk është përcaktuar në mënyrë të saktë, pasi në rastin e secilit të akuzuar ka data të ndryshme që caktohen si ndërprerje e veprimtarive. Nuk është e qartë nëse krahas të akuzuarit ishte anëtarë të tjerë të këtij grupi. Nuk është e qartë se në çfarë baze faktike gjykata ka konstatuar se grupi ka ekzistuar në periudhën në mes 16 tetorit 2012 deri më 13 shkurt 2013, dhe pse datën e fundit të veprimeve Gjykata i ka lidhur me G [REDACTED] L [REDACTED], të vetmin pjesëmarrës të grupit terrorist i cili ishte ende aktiv.

48. Vetë dispozitivi ngre shumë dyshime për veprimet që i atribuohen secilit të akuzuar për shkak se ato janë paraqitur në një mënyrë shumë të paqartë. Në rastin e të akuzuarve G [REDACTED] L [REDACTED], A [REDACTED] Z [REDACTED], S [REDACTED] S [REDACTED] i, M [REDACTED] A [REDACTED] dhe Q [REDACTED] R [REDACTED] j nuk është e kuptueshme nëse ata kanë marrë pjesë vetë në sulme të kryera më 17 maj, 28 qershor dhe 07 tetor 2012, pasi pjesët përkatëse të dispozitivit në rast të secilit prej të akuzuarve pohojnë si më poshtë:

"(...) kanë marrë pjesë aktive në një grup terrorist të vetëquajtur e të njohur si "Lëvizja e Lirisë", e cila ka kryer sulmet ndaj instalimeve të policisë serbe më 17 maj, 28 qershor dhe 07 tetor 2012, duke e vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij dhe duke bërë kryerjen e

¹³ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, faqe 32, versioni në gjuhën angleze.

¹⁴ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, faqe 33, versioni në gjuhën angleze.

¹⁵ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, faqe 34, versioni në gjuhën angleze.



*veprave penale të përshkruara më lart në një vend të papërcaktuar, duke filluar më së voni nga prilli 2012 (...)*¹⁶

49. Nuk ka asnjë vlerësim të duhur të provave, veçanërisht të atyre shfajësuese. Në fakt, analiza e tillë ishte paraqitur vetëm në rastin e V [REDACTED] J [REDACTED], dhe E [REDACTED] M [REDACTED]. Në rastin e të akuzuarve të tjerë, Gjykata kryesisht prezantoi materialin fajësues kundër tyre, shpesh e duke përmbajtur veten vetëm në përfundimin se ka shumë prova, pa treguar provat e sakta, si për shembull:

*"Për më shumë, ka prova të mjaftueshme se G [REDACTED] L [REDACTED] mori pjesë në një ekspeditë të tipit ushtarak më 14 - 15 qershor 2012."*¹⁷

*"Nuk i shpëtoi vëmendjes së kolegjit që E [REDACTED] M [REDACTED] ka marrë pjesë në dy ekspedita shtesë të "Lëvizjes së lirisë", më 18 mars dhe 16 maj 2012. Konstatimi i këtij kolegji është se këto ekspedita ushtarake ishin menduar për të rritur kapacitetet ushtarake të grupit për ta përgatitur atë për sulme terroriste kundër qeverisë së Republikës së Serbisë."*¹⁸

*"Anëtarësimi i G [REDACTED] X [REDACTED] në grup vërtetohet edhe nga fakti se, siç u shpjegua më lart, ai është parë së bashku me V [REDACTED] J [REDACTED] dhe E [REDACTED] M [REDACTED] në ditën kur ai mori pjesë në sulmin që Lëvizja ka kryer më 28 qershor 2012."*¹⁹

50. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm si për akuzën e posedimit të armës e cila kishte për t'u kryer nga të gjithë të akuzuarit, si një akt i terrorizmit. Ekzistojnë vetëm disa tregues të vogël të disa rrethanave që lidhen me këtë, por vetëm në rastin e V [REDACTED] J [REDACTED] dhe G [REDACTED] L [REDACTED].
51. Për më tepër, ka shumë kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsytimit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Së pari, dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin lidhur me sulmet në të cilat të pandehurit ishin të përfshirë.
52. Gjykata e shkallës së parë në dispozitiv konstaton se V [REDACTED] J [REDACTED] G [REDACTED] X [REDACTED] dhe E [REDACTED] M [REDACTED] "në bashkëkryerje kanë marrë pjesë në sulmin të datës 28 Qershor 2012". Në mënyrë të ngjashme, lidhur me S [REDACTED] J [REDACTED], thuhet se "ai në bashkëkryerje me E [REDACTED] M [REDACTED] kishin marrë pjesë në sulmin e datës 7 tetor 2012". Kështu, në dispozitiv aktgjykimi implikon S [REDACTED] J [REDACTED] vetëm për sulmin që ka ndodhur më 7 tetor 2012. Megjithatë, në pjesën e arsytimit

¹⁶ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, faqe 6, 8, 9, 10, 12., versioni në gjuhën angleze.

¹⁷ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, faqe 31, versioni në gjuhën angleze.

¹⁸ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, faqe 34, versioni në gjuhën angleze.

¹⁹ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, faqe 37, versioni në gjuhën angleze.



thuhet se "fotot e gjetura në kompjuterin e vëllait të J [REDACTED] tregojnë qartë se S [REDACTED] J [REDACTED] mori pjesë në të paktën katër ekspedita shtesë më 18 mars, 28 prill, 1 dhe 6 maj 2012²⁰.

53. Për sa i përket E [REDACTED] M [REDACTED], në dispozitiv gjykata e implikon atë në sulmin e datës 28 qershor 2012, ndërsa në arsyetim thuhet se E [REDACTED] M [REDACTED] "është dëshmuar të jetë anëtar i devotshëm i "Lëvizjes së Lirisë", i cili mori pjesë aktive në dy sulmet terroriste ndaj Policisë Kufitare Serbe më 28 qershor dhe 7 tetor 2012²¹. Më tej, në arsyetim thuhet se "kjo nuk i shpëtoi vëmendjes së kolegjit që ai mori pjesë në dy ekspedita shtesë të "Lëvizjes së Lirisë", më 18 mars dhe 6 maj 2012²².
54. Në lidhje me G [REDACTED] L [REDACTED], dispozitivi implikon atë në sulmet e datës 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012, ndërsa arsyetimi lexon "përveç kësaj, ka prova të mjaftueshme se G [REDACTED] L [REDACTED] ka marrë pjesë në ekspedita të tipit ushtarak më 14-15 qershor 2012²³.
55. Në të njëjtën mënyrë në lidhje me A [REDACTED] Z [REDACTED], arsyetimi pohon se "ka dëshmi të forta se ai mori pjesë në dy ekspedita të tipit ushtarak në mes të majit dhe në mes të qershorit të vitit 2012". Arsyetimi vijon duke thënë se "ai mori pjesë në një aktivitet zbulues së bashku me S [REDACTED] J [REDACTED] më 17-18 qershor 2012²⁴. Dispozitivi megjithatë e implikon atë në sulmet e datës 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012.
56. Në mënyrë të ngjashme, përkitazi me M [REDACTED] A [REDACTED], arsyetim pohon se "anëtarësimi i tij në këtë organizatë terroriste vërtetohet edhe nga fakti se ai vetë mori pjesë në ekspedita në mesin e qershorit 2012, si dhe mesin e majit 2012, gjatë të cilave ai është fotografuar duke tundur armët e luftës²⁵", ndërsa dispozitivi e implikon atë në sulmet e datës 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012.
57. Për më tepër, në lidhje G [REDACTED] X [REDACTED], në dispozitiv thuhet se kishte marrë pjesë në ekspeditë të datës 28 Qershor 2012, ndërsa në arsyetim thuhet se "ai ka marrë pjesë edhe në dy ekspedita të stitit ushtarak me anëtarët e tjerë të "Lëvizjes së Lirisë" V [REDACTED], S [REDACTED] J [REDACTED] Q [REDACTED] R [REDACTED] M [REDACTED] A [REDACTED] S [REDACTED] S [REDACTED] A [REDACTED] Z [REDACTED] dhe G [REDACTED] L [REDACTED] më 15 maj dhe 14/15 qershor 2012²⁶.

²⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, faqe 26, versioni në gjuhën angleze.

²¹ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, faqe 33, versioni në gjuhën angleze.

²² Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, faqe 34, versioni në gjuhën angleze.

²³ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, faqe 31, versioni në gjuhën angleze.

²⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, faqe 32, versioni në gjuhën angleze.


²⁵ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, faqe 40, versioni në gjuhën angleze.

²⁶ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, faqe 37, versioni në gjuhën angleze.




58. Sa i përket S [REDACTED] S [REDACTED], në arsyetim është thënë se "është konstatuar se ai ka marrë pjesë jo vetëm në ekspeditën e majit të vitit 2012, por edhe në një tjetër në mes të qershorit 2012²⁷", ndërsa dispozitivi i referohet të ekspeditave të datës 17 maj, 28 qershor dhe 7 tetor 2012.
59. Kolegji konstaton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka vlerësuar provat e prezantuara nga prokuroria në mënyrë të izoluar nga provat e tjera, dhe me këtë ka bërë përzgjedhje artificiale të provave inkriminuese kundër të akuzuarve, duke shkelur në këtë mënyrë parimet themelore të procedurës penale, siç është prezumimi i pafajësisë dhe gjykimi i drejtë. Kolegji thekson se elementet e trajtimit të padrejtë të provave nga ana e gjykatave, kur kanë të bëjnë me thelbin, (siç është rasti këtu- elementet lidhur me pjesëmarrjen e të pandehurit në sulme) mund të çojnë në përcaktim të padrejtë të fakteve në rasti e caktuar.
60. Lidhur me sulmin që ka ndodhur më 7 tetor 2012, pretendohet nga i pandehuri S [REDACTED] J [REDACTED] se gjatë kësaj kohe ndaj tij ishte shqiptuar masa e lajmërimit në stacionin e policisë. Gjykata nuk ka asnjë dëshmi në shkresa të lëndës se policia në pajtueshmëri me ligjin kishte njoftuar prokurorin publik ose gjykatën menjëherë për shkeljen e masës së sigurisë në rast se ka ndodhur. Raportet e policisë në lidhje me respektimin e masave të kufizimit nga ana e të pandehurve të paktën do të kishin konfirmuar versionin e të pandehurve për ngjarjet ose do t'i kishin siguruar gjykatës informacione thelbësore në mënyrë që të mos u falë besimin deklaratave të tyre. Megjithatë, gjykatat nuk kishin autorizuar asnjë provë të tillë.
61. Aktgjykimet japin shpjegime të pamjaftueshme nga e cila mund të arrihet në përfundim rreth lidhjes mes të akuzuarve dhe veprimeve inkriminuese të tyre. Për sa i përket posedimit të armëve si një akt terrorizmi gjykatat më të ulëta thjesht i referohen fotografive në të cilat të pandehurit shfaqen në uniforma, dhe raporteve të përgjimeve të cilat formuan themelet mbizotëruese për dënimin e të akuzuarve. Megjithatë, kolegji konstaton se nuk ka sqarim të mjaftueshëm që tregon se armët të cilat të pandehurit bartin në fotografi janë të lidhura në të vërtetë me grupin terrorist të dyshuar. Në fakt, armët e përmendura nga gjykatat të përdorura në sulmet asnjëherë nuk janë gjetur, ose konfiskuar. Arma e vetme, revolva e gjetur dhe e konfiskuar gjatë bastisjes më 1 qershor 2012, në banesën e vëllezërve J [REDACTED], nuk është përmendur të jetë përdorë gjatë sulmeve. Prandaj, kjo tërësi elementesh që kanë të bëjnë me trajtimin e provave në gjykim dhe në Gjykatën e Apelit ngritin pyetje sa i përket procedurës së drejtë.

²⁷ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, faqe 42, versioni në gjuhën angleze.



62. Nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor është evidente se gjykata e shkallës së parë ka dëgjuar disa dëshmitarë dhe ekspertë. Përveç vënies në dukje se një numër i dëshmitarëve ka dëshmuar, aktgjykimi nuk ofron një analizë të detajuar sa i përket besueshmërisë dhe vlerës provuese të dëshmive të tyre.
63. Trupi gjykues gjithashtu ka dëgjuar edhe të pandehurit, por aktgjykimi nuk përmban vlerësimin e deklaratave të tyre, përveç të të pandehurve S [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR] dhe E [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR]. Në rastin e të akuzuarve të tjerë nuk ka as prezantim të dëshmive të tyre e as ndonjë sqarim se pse gjykata nuk i ka pranuar versionet e tyre të incidenteve.
64. Gjykata e Apelit e ka pranuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është aq i detajuar, dhe ka vërejtur praninë e kundërthënies, mangësive dhe mospërputhjeve në provat e paraqitura gjatë gjyqimit, posaçërisht gjatë krahasimit të deklaratave të mëparshme të të pandehurve të marra në fazat e mëhershme të procedurës penale me ato të dhëna gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor.
65. Gjykata Supreme nënvizon se prania e kundërthënies apo mospërputhjeve nuk e përjashton në mënyrë automatike dëshminë e të pandehurit. Duhet theksuar se gjykata në çdo rast duhet të ekzaminojë natyrën e kundërthënies së dëshmisë, si: nëse ka të bëjë me elementet faktike materiale apo sekondare, nëse janë të shpjegueshme ose jo, dhe nëse në dritën e rrethanave të përgjithshme dëshmia ka vlerë provuese. Duhet të paraqitet argumentim i duhur në aktgjykimin me shkrim, gjë që është përcaktuar në mënyrë strikte me nenin 370 të KPP-së.
66. Gjykata duhet të shqyrtoj me kujdes të veçantë, kur pjesa më e madhe e provave bazohet bazuar në përgjim, dhe i akuzuari apo atribuimi për kryerjen e veprimtarisë së caktuar penale të të akuzuarit është ndërtuar në fotografi ose prova dokumentare, siç ka ndodhur në rastin konkret. Mospërputhjet thelbësore që ndodhin në mes të dëshmive në hetuesi dhe në gjykim nuk duhet automatikisht dhe në mënyrë kolektive të shpërfillen për efekte të favorizimit të prokurorisë.
67. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk përmban arsyetim të duhur sa i përket cilësimit juridik të veprave penale që i atribuohen të akuzuarin. Citimi *in extenso* i të gjitha dispozitave të Kodit Penal në lidhje me terrorizmin nuk i plotëson kushtet për të deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë se pse janë aplikuar dispozitat specifike të ligjit penal. Për fat të keq, ky gabim nuk është




korrigjuar nga Gjykata e Apelit, përkundër faktit se disa prej avokatëve mbrojtës e kanë ngritur këtë argument në ankesat e tyre²⁸.

68. Gjykata Supreme nuk do të shqyrtojë të gjitha kontradiktat dhe lëshimet në aktgjykimet vendimet e gjykatave më të ulëta. Ato të cilat u diskutuan më lart janë të mjaftueshme për të vënë në pikëpyetje qasjen e gjykatave më të ulëta në lidhje me prezantimin e gjetjeve dhe vlerësimin e provave, të cilat ngritin pyetje sa i përket një procedure gjyqësore të drejte. Rrjedhimisht, është dëmtuar saktësia e të gjeturave të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit.
69. Kolegji e konsideron të duhur të theksoj se vlerësimi i tij është i kufizuar në atë nëse gjykatat më të ulëta kanë shkelur të drejtat procedurale të të pandehurve. Me fjalë të tjera, fushëveprimi i Gjykatës Supreme kur vepron sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, nuk është për të shprehur një mendim mbi rëndësinë e provave të paraqitura apo të refuzuara, ose në përgjithësi për fajësinë ose pafajësinë e të pandehurve..
70. Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, kolegji konstaton se kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitura nga avokatët mbrojtës për G [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR], M [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR], dhe S [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] dhe nga i akuzuari V [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR] duke u bazuar në bazën e shkeljeve të kodit të procedurës penale, konkretisht nenit 384 (1.12) të KPP-së në lidhje me nenin 370 të KPP-së, janë të bazuara. Sipas mendimit të kolegjit, pesha e shkeljeve nuk lejon ndryshimin e aktgjykimëve, dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim në Gjykatën Themelore.

Përbërja jo e duhur e kolegjit të Gjykatës së Apelit

71. Ky argument, i ngritur nga i akuzuari S [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], do të trajtohet sikur ai në bazë të nenit 384 (1.1) të KPP-së, dhe si i tillë mund të përbëjë bazë për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimin (neni 432 (1.2) të KPP-së). Kolegji e gjen të pabazuara pretendimet pasi që përbërja e kolegjit të Gjykatës së Apelit ishte në pajtim me *Ligjin mbi gjykatat dhe Ligjin mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë* (Ligji Nr. 03 / L-053), i ndryshuar me Ligjin nr. 04 / L-273. Interpretimi i këtyre dispozitave është shtjelluar në hollësi në pjesën që i referohet përbërjes së këtij kolegji, për këtë arsye nuk është e nevojshme që të shpjegohen përsëri.

²⁸ Shumica e ankesave kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë pretendojnë në shkelje të dispozitave të kodit penal si rezultat i shkeljes së pretenduar të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Në mënyrë të veçantë, ankesat pohojnë se dispozitivi i aktgjykimin të kundërshtuar nuk përmban elementet thelbësore të krimeve për të cilat të akuzuari janë shpallur fajtorë. Tre avokatët mbrojtës (S [REDAKTUAR] P [REDAKTUAR], në ankesën e tij e paraqitur në emër të të pandehurit G [REDAKTUAR] B [REDAKTUAR]; këshillon G [REDAKTUAR] E [REDAKTUAR] dhe R [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] në ankesën e tyre e paraqitur në emër të të pandehurit Q [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] dhe avokati D [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] në ankesën e tij parashtruar në emër të pandehurit S [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR]) kanë argumentuar në mënyrë eksplicite shkeljet e nenit 113 (3) të KPRK-së, përkatësisht neni 143 (2) të KPK-së.



Shkeljet tjera të dispozitave të procedurës penale

Nenet 314 (1.2) dhe 369 (1) të KPP-së

72. I akuzuari S [REDACTED] J [REDACTED] ka paraqitur kundërshtimin se gjykimi ka zgjatur më shumë se 120 ditë që ka shkelur nenin 314 (2) të KPP-së. Më tej, ai dhe avokati mbrojtës i M [REDACTED] A [REDACTED] pretendojnë se dispozita e nenit 369 (1) të KPP-së është shkelur nga Gjykata Themelore pasi që aktgjykimi është shkruar 75 ditë pas afatit, dhe ky argument nuk është vlerësuar nga ana e Gjykatës së Apelit.

73. Kolegji pajtohet se kanë ndodhur shkeljet e paraqitura. Megjithatë, afatet për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor dhe për dorëzimin e aktgjykimit me shkrim nuk bien nën kategorinë e afateve strike. Të dy afatet kanë vetëm karakter udhëzues pasi që ligji nuk parashikon ndonjë pasojë nëse ato nuk respektohen. Prandaj, kjo shkelje procedurale nuk ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore në këtë lëndë. (Neni 432 (1.3) i KPP-së).

Parimi ne bis in idem

68. I akuzuari S [REDACTED] J [REDACTED] ka pretenduar se është shkelur parimi *ne bis in idem* pasi që ai është akuzuar për veprën e njëjtë penale për të cilën është ndjekur penalisht gjithashtu edhe nga autoritetet e Serbisë.


69. Parimi *ne bis in idem* rregullohet me nenin 4 të KPP-së:

Askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për vepër penale nëse është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës.

70. Kolegji konstaton se pretendimi i ngritur nga i akuzuari S [REDACTED] J [REDACTED] se është shkelur parimi *ne bis in idem* është i pabazuar pasi që nuk ka asnjë aktgjykim të formës së prerë ndaj tij për akuzat të cilat janë çështje e kësaj lënde.

Nenet 222, 384 (2) të KPP-së, dhe neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

71. Avokati mbrojtës i S [REDACTED] S [REDACTED] nuk e ka arsyetuar se në çfarë mënyre këto shkelje të pretenduara të procedurës penale mund të kenë ndikuar në vendimin gjyqësor. Prandaj, kolegji nuk ka parë të nevojshme që të marrin parasysh këto arsye pasi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të bazohet në to (neni 432 (1.3) i KPP-së).



Shkelja e ligjit penal

Neni 113 KPK/143 KPRK

72. Të gjithë avokatët mbrojtës të cilët kanë paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë pretenduar se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Themelore kanë shkelur ligjin penal. Mbrojtja e S [REDACTED] S [REDACTED] dhe M [REDACTED] A [REDACTED] ka pretenduar në shkelje të nenit 113 të KPK-së/143 KPRK-së, sepse gjykatat gabimisht kanë pranuar se pjesëmarrja në organizatë terroriste mund të kryhet në mënyrë pasive, pa ndonjë aktivitet, ndërsa dispozita në fjalë në mënyrë strikte përcakton se "pjesëmarrja aktive" është një element i rëndësishëm i kësaj vepre penale. Mbrojtja e G [REDACTED] L [REDACTED] ka specifikuar se neni 31 i KPK-së është shkelur pasi që gjykatat nuk arritën të marrin në konsideratë siç duhet përkufizimin e saj.

73. Pjesëmarrja në grup terrorist dënohet në nenin 143 (2) të KPK-së, dhe ka qenë e dënueshme me nenin 113 (3) të KPRK-së. Përkufizimet në të dy kodet dallojnë pak pasi që në Kodin aktual përcaktohet:


"Kushdo që merr pjesë në veprimtaritë e grupit terrorist (...)"

Kurse në kodin e mëhershëm ka qenë e përcaktuar:

"Kushdo që merr pjesë aktivisht në një grup terrorist (...)".

74. Kolegji e konsideron të nevojshme t'ua rikujtojë se përkufizimi i veprës penale duhet të interpretohen në mënyrë strikte dhe interpretimi sipas analogjisë nuk lejohet. Ky është njëri nga parimet themelore të së drejtës penale, i shprehur sipas maksimës "Nullum crimen sine lege". Një qasje e tillë është mbështetur nga jurisprudenca e gjerë e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 7 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të cilat përcaktojnë parimin se vetëm ligji mund të përcaktojë një krim dhe të përcaktojë një dënim. Aty vlijohet se veprat penale dhe dënimet përkatëse duhet të përcaktohen qartë me ligj.

75. Për të respektuar parimin e ligjshmërisë, fushëveprimi i krimit dhe dënimi i zbatueshëm duhet të përcaktohen në terma të qarta para kryerjes së tij. Duke pasur parasysh funksionin e ligjit penal në shoqëri, ajo është gjithashtu një kërkesë thelbësore e drejtësisë që individi duhet të jetë në gjendje të dijë paraprakisht nëse veprimet e tij janë të dënueshme. Kështu, parimi i ligjshmërisë është një faktor i rëndësishëm legjitimiteti i çdo sistemi të së drejtës penale. Edhe pse nevoja që dispozitat penale të jenë të qarta nuk është shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë në konventat



ndërkombëtare, siguria në përgjithësi konsiderohet të jetë një komponent i natyrshëm i parimit të ligjshmërisë. Kushti i sigurisë i adresohet autorit të dispozitave penale. Ai thekson se sjellja kriminale duhet të përcaktohet në mënyrë të tillë që individi, nëse është e nevojshme me ndihmën e interpretimeve tashmë ekzistuese gjyqësore të ligjit dhe/ose me ndihmën e këshillimit ligjor, dhe duke marrë parasysh kualifikimet e mundshme specifike të pranuesit tipik, mund të sheh nga formulimi i përkufizimit të sjelljes kriminale se cilat akte ose lëshimet janë të ndaluara.


76. Pikënisja për Interpretimin e cilësdo dispozite ligjore është një qasje gjuhësore. Kushdo që dëshiron të gjejë se cilat elemente përbëjnë veprën penale, duhet të fillojnë nga kuptimi verbal i normës juridike. Ekziston edhe një supozim se ligjvënësi është racional, dhe si i tillë nuk përdor asnjë fjalë në mënyrë sipërfaqësore. Çdo shprehje duhet të ketë kuptimin e vet.
77. Sipas mendimit të kolegjit, ekziston një dallim i madh në mes të "pjesëmarrjes aktive" dhe vetëm "pjesëmarrjes", si dhe në mes të nocionit "merr pjesë në aktivitetet e një grupi terrorist" dhe "merr pjesë në një grup terrorist". Në të dyja rastet, e para kërkon që një person t'i ndërmarrë disa veprime të veçanta, duke u angazhuar personalisht në ekzekutimin e tyre, për të treguar një aktivitet, jo vetëm për të demonstruar vullnetin e pastër të pjesëmarrjes, apo të mbështes atë që mund të jetë e mjaftueshme për vetë pjesëmarrjen.
78. Diferencim i tillë në mes të pjesëmarrjes dhe pjesëmarrjen aktive është i dukshme edhe në të drejtën ndërkombëtare. Si për shembull, ia vlen t'i referohemi Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional në Palermo²⁹ nenit 5 ku thuhet:

Çdo Shtet Palë duhet të adaptojë masa të tilla ligjore dhe masa të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme për të cilësuar si vepra penale, në rastet kur kryhen qëllimisht:

a) secilin ose të dy prej rasteve të mëposhtme si vepra penale të dallueshme nga ato që përfshijnë tentativën ose kryerjen e aktivitetit kriminal:

(i) Marrëveshjen me një ose disa persona të tjerë për të kryer një krim serioz për një qëllim që lidhet direkt ose jodirekt me marrjen e përfitimeve financiare ose materiale dhe, nëse kërkohet nga legjislacioni i brendshëm, që përfshin një veprim të ndërmarrë nga një prej pjesëmarrësve në zbatim të marrëveshjes, ose që përfshin një grup të organizuar kriminal;

²⁹ <http://www.unodc.org/documents/treaties/UNTOC/Publications/TOC%20Convention/TOCbook-e.pdf>



(ii) Veprimin e një personi, i cili, duke njohur qëllimin dhe aktivitetin e përgjithshëm kriminal të një grupi të organizuar kriminal ose synimin e tij për të kryer krimet në fjalë, merr pjesë aktivisht në:

(a) Veprimtaritë kriminale të grupit të organizuar kriminal;

(b) Veprimtaritë e tjera kriminale të grupit të organizuar kriminal, duke ditur se pjesëmarrja e tij/saj do të kontribuojë në arritjen e qëllimit kriminal të përshkruar më lart;

Instanca tjetër e modelit të tillë të dyfishtë të përgjegjësisë është përfshirë edhe në legjislacionin e BE-së, f.e. në Vendimin Kornizë të Këshillit për luftën kundër krimit të organizuar i cili i referohet kriminalizimit të pjesëmarrjes në një organizatë kriminale. Sipas nenit 2:

Çdo Shtet Palë duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar që të dy llojet e veprimeve në vijim që kanë të bëjnë me organizatën kriminale do të konsiderohen si vepra penale:

a. Veprimi i çdo personi, i cili, me dashje dhe me njohuri për qëllimin dhe aktivitetin e përgjithshëm kriminal të një organizate kriminale ose synimin e tij për të kryer krimet në fjalë, merr pjesë aktivisht në aktivitetet kriminale të organizatës, përfshirë sigurimin e informatave ose mjeteve materiale, rekrutimin e pjesëtarëve të rinj dhe të gjitha format e financimit të aktiviteve të saj, duke ditur se pjesëmarrja e tillë do të kontribuojë në arritjen e aktiviteve kriminale të organizatës;

b. Veprimi i çdo personi, i cili konsiston në marrëveshjen me një apo më shumë persona se një aktivitet duhet të vazhdohet, i cili nëse kryhet, do të përbënte kryerje të veprës penale të referuar në nenin 1, madje edhe nëse ai person nuk merr pjesë në ekzekutimin aktual të aktivitetit.

79. Në qoftë se i akuzuari nuk merr pjesë në aktivitetet e një grupi terrorist (neni 143 (3) i KPK-së), ose nuk merr pjesë në mënyrë aktive në një grup terrorist (neni 113 (3) i KPRK-së), person i tillë nuk mund të ketë kryer vepra penale të përcaktuara me dispozitat përkatëse të të dy kodeve. Megjithatë, është e nevojshme të merret parasysh nëse ndonjë sjellje specifike e të pandehurit mund të përbëjë vepra penale sipas ndonjë dispozite tjetër të ligjit penal pasi gjykata nuk obligohet nga propozimet e prokurorit në lidhje me cilësimin juridik të veprës (neni 360 i KPP-së).

80. Siç u përmend më lart, aktgjykimet e të dy instancave nuk janë të qarta në lidhje me mënyrën se si të akuzuarit G [REDACTED] L [REDACTED], Q [REDACTED] R [REDACTED], M [REDACTED] A [REDACTED] dhe S [REDACTED] S [REDACTED] kanë marr pjesë në organizatën terroriste. Dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit, tregon se secili prej tyre "kishte vënë veten në dispozicion të grupit terrorist për aktivitetet e tij, dhe duke kryer veprat penale të përshkruara më lart". Prandaj, nuk është e qartë nëse të akuzuarit kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në grupin terrorist / kanë marrë pjesë në një grup terrorist, apo ata vetëm janë "ofruar për të marrë pjesë" në të, çfarëdo që do të thotë kjo në rastin konkret.
81. Kolegji konstaton se "vënia në dispozicion" nuk është e barabartë me nocionin "pjesëmarrje aktive" ose "pjesëmarrje në aktivitetet." Varësisht nga rrethanat e veçanta faktike, është e nevojshme të merret parasysh nëse do të mund të shfrytëzohet ndonjë dispozitë tjetër ligjore për cilësimin e një sjellje të tillë.
82. Pa asnjë paragjykim për rezultatin e rigjykimit në këtë lëndë, Gjykata Supreme vëren se "vënia në dispozicion të grupit terrorist" mund të përbëjë një veprë penale të përcaktuar me nenin 144 (1) të KPK-së i cili dënon përgatitjen për kryerjen e veprave penale nën nenet 135 - 142 të këtij Kodi. Për qëllime të këtij neni, shprehja "përgatitje e veprës penale" përfshin furnizimin apo aftësimin e mjeteve kryesve për kryerjen e veprës penale, eliminimin e pengesave për kryerjen e veprës penale, marrëveshjen, planifikimin apo organizimin me personat e tjerë për kryerjen e veprës penale, si dhe çfarëdo veprime tjera që krijojnë kushte për kryerjen e drejtpërdrejtë të veprës penale, por të cilat nuk e përbëjnë vet veprën penale (neni 144 (2) i KPK-së). Dënimi me burgim i cili mund të shqiptohet është prej 1 deri në 5 vjet.
83. Këto aktivitete, të cilat tani do të cilësohen në bazë të nenit 144 (1) të KPK-së, përbëjnë veprë penale edhe sipas ligjit të mëparshëm penal. Sipas atij ligji, ato mund të ishin cilësuar si dhënie e mbështetjes për grupin terrorist, në pajtim me nenin 113 (2) të KPRK-së që ishte e dënueshme me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.
84. Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, kolegji konstaton se kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga mbrojtja e S [REDACTED] S [REDACTED] dhe M [REDACTED] A [REDACTED] mbi bazën e shkeljes së ligjit penal, konkretisht nenit 113 të KPK-së, janë të bazuara.

Neni 31 i KPRK-së

85. Mbrojtja e G [REDACTED] L [REDACTED] e ka bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë edhe në shkeljen e pretenduar të nenit 31 të KPRK-së. Mbrojtja ka dështuar të shpjegojë se si kjo dispozitë është

shkelur nga gjykatat, pasi që në lidhje me këtë pikë parashtresa është përqendruar në bindjen e Gjykatës Supreme se ekzistojnë gjetje faktike të gabuara. Prandaj, kolegji konstaton se ky pretendim është i pabazuar.

Ligji për amnistinë

86. Shkelja e pretenduar e Ligjit për amnistinë e paraqitur nga mbrojtja e S [REDACTED] S [REDACTED] tashmë është gjetur si e pabazuar nga Gjykata e Apelit. Kolegji plotësisht pajtohet me interpretimin ligjor të këtij ligji, të paraqitur nga Gjykata e Apelit³⁰, kështu që nuk ka nevojë që të përsëritet. Prandaj, ky pretendim është refuzuar si i pabazuar.

Nenet 135 (1.10) dhe 136 të KPRK-së

87. Mbrojtja e S, S, [REDACTED] nuk e ka mbështetur pretendimin e tij sa i përket shkeljes së neneve 135 (1,10) dhe 136 të KPRK-së, pasi që ai kryesisht ka kontestuar gjetjet faktike të bëra nga gjykatat e shkallëve më të ulëta. Prandaj, nuk ka asnjë bazë për ta pranuar këtë pretendim.

Beneficium cohaesionis


88. Kolegji gjen se arsyet për vendosje në favor të të akuzuarve M [REDACTED] A [REDACTED] S [REDACTED] S [REDACTED], G [REDACTED] L [REDACTED] dhe S [REDACTED] J [REDACTED] ekzistojnë edhe në lidhje me të bashkakuzuarit e tjerë për të cilët nuk është paraqitur fare kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë (Q [REDACTED] R [REDACTED] E [REDACTED] M [REDACTED] dhe A [REDACTED] Z [REDACTED]), ose është paraqitur, por nuk është pranuar ([REDACTED] J [REDACTED], G [REDACTED] X [REDACTED]). Prandaj, duke vepruar sipas nenit 436 (2) të KPP-së, kolegji ka vendosur të procedojë sipas detyrës zyrtare sikur një kërkesë e tillë të jetë paraqitur gjithashtu, dhe ka anuluar aktgjykimet e të dy shkallëve gjithashtu edhe në lidhje me të akuzuarit S [REDACTED] J [REDACTED], Q [REDACTED] R [REDACTED] E [REDACTED] M [REDACTED] dhe A [REDACTED] Z [REDACTED].

Udhëzim për rigjykim

89. Gjykata Themelore do të mbajë shqyrtimin gjyqësor nga fillimi, ku provat duhet të paraqiten në atë mënyrë siç parashikohet me Kodin e Procedurës Penale për të shmangur shkeljet dhe mangësitë të cilat janë vërejtur nga kolegji në procedurën e mëparshme.

90. Kolegji e konsideron të nevojshme të theksojë se një nga elementet e gjykit të drejtë dhe të drejtës për mbrojtje është e drejta për t'u dëgjuar, edhe përmes marrjes në pyetje të duhur gjatë shqyrtimit kryesor. Në këtë kontekst, kolegji ka vërejtur se marrja në pyetje e të akuzuarit nuk është kryer në përputhje me nenin 346 të KPP-së i cili përcakton se dëshmia e të pandehurit, nëse

³⁰ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, f. 35 – 37, versioni në gjuhën angleze



ai vendos të deklarohet, do të merret në mënyrë të duhur, gjegjësisht mbrojtësi kryesor fillon me marrjen e drejtpërdrejtë në pyetje, pastaj prokurori – vazhdon me marrjen e tërthortë në pyetje, dhe në fund mbrojtësi mund ta rimarrë në pyetje. Vetëm pas përfundimit të këtyre fazave, ka kohë për gjyqtarin e vetëm gjykues ose kryetarin e trupit gjykues që të vazhdojë me marrjen në pyetje, në qoftë ende ka boshllëqe, paqartësi dhe kontradikta që duhet sqaruar.

91. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të qartë tregon se Gjykata Themelore nuk e ka respektuar mënyrën e përcaktuar për marrjen në pyetje, çuditërisht pa një reagim të duhur të mbrojtjes, jo vetëm duke shkelur rendin e bërjes së pyetjeve për të pandehurit, por gjithashtu edhe duke e kufizuar marrjen në pyetje në konfirmimin e deklaratave të dhëna gjatë hetimit. Shumicës së të pandehurve nuk iu kujtua përmbajtja e tyre, për këtë arsye ata u janë dhënë disa minuta për t'i lexuar, dhe pastaj janë pyetur nëse ata mbështesin dëshmitë e tyre të mëparshme. Në këtë mënyrë, kjo provë nuk është marrë në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, dhe të pandehurit janë privuar nga mundësia për t'u dëgjuar si duhet.
92. Njëri nga parimet thelbësore të së drejtës penale është që i pandehuri të dijë qartë se për çfarë vepre është ai ose ajo shpallur fajtor/e. Për këtë arsye, gjykata ka obligim t'i shqyrtojë në hollësi elementet e krimeve dhe fakteve të vërtetuara gjatë gjykimit, dhe të sigurohet se faktet e vërtetuara dëshmojnë secilin element të krimit. Rëndësia e vërtetimit të fakteve në çështje të caktuar nuk mund të merret parasysh ndaras nga elementet e krimeve të cilat i pandehuri pretendohet se i ka kryer. Është absolutisht e domosdoshme të vërtetohen sikur elementet e krimit ashtu edhe rrethanat faktike të çështjes.
93. Elementet e krimit janë të përcaktuara në dispozitat penale, ose rastet në juridiksione që lejojnë sipas jurisprudencës. Me përjashtime, çdo krim ka së paku tri elemente: aktin kriminal, të njohur edhe si *actus reus*; dashjen kriminale, të njohur edhe si *mens rea*; dhe bashkëveprimin e të dyjave. Fillimisht, duhet të vërtetohen elementet materiale (ose objektive) – çfarë lloji i veprimit kriminal është kryer dhe çfarë elemente janë mbledhur në çështje për të treguar se ekziston çdo element material i krimit të caktuar. Më tutje, një person mund të shpallet penalisht përgjegjës dhe të ndëshkohet për një krim brenda juridiksionit të një vendi të caktuar vetëm nëse elementet materiale të krimit janë kryer me dashje dhe njohuri (elementi subjektiv). Ekzistenca e dashjes dhe njohurisë mund të nxirret nga faktet dhe rrethanat relevante.
94. Me vërtetimin e fakteve në lidhje me çdo element të krimit, gjykata vërteton se nuk mund të rrjedhë asnjë shpjegim tjetër logjik nga ato fakte përveç se i pandehuri ka kryer krimin, dhe me këtë e tejkalon prezumimin se njeriu është i pafajshëm përderisa nuk vërtetohet fajësia e tij.

Kësisoj, gjykata duhet të sigurojë se në arsyetim të aktgjykimit do të sqarohet mirë dhe shprehimisht se ka mjaft prova për të dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm ekzistimin e secilit element të krimit të përcaktuar në Kodin Penal.

95. Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, gjykata nxjerrë aktgjykimin i cila duhet të përmbushë të gjitha kushtet e përcaktuara me ligj. Dispozitivi duhet të jetë i qartë, specifik dhe konkrete. Në rast se gjykata shpall të pandehurit fajtorë, aktgjykimi duhet të përmbajë të gjitha faktet vendimtare dhe rrethanat që përbëjnë elementet e veprave penale dhe që konfirmojnë se personi ka kryer veprën penale të përmendur. Në aktgjykimin e shkruar, gjykata duhet të deklarojë në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, si dhe arsyet për këtë. Gjkata, në veçanti, do ta bëjë vlerësimin e besueshmërisë së provave kundërthënëse, arsyet për mos aprovimin e propozime individuale të palëve, si dhe arsyet nga të cilat gjykata është udhëhequr në zgjidhjen pikave të ligjit dhe, në veçanti, në vërtetimin e ekzistencës së veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe veprës së tij ose të saj.

96. Palët kanë të drejtë të paraqesin fakte dhe prova të reja.

97. Me rastin e marrjes së vendimit të ri, gjykata detyrohet me ndalesën e paraparë në nenin 395 të KPP-së.

Vendimi përkritazi me ndërprerjen e dënimit

98. Duke marrë parasysh se aktgjykimet e lëshuara në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e shkallës së dytë janë anuluar, kolegji konsideron se vuajtja e dënimit e të pandehurve duhet të ndërpritet menjëherë, në përputhje me nenin 435 paragrafin 4 të KPP-së. Megjithatë, të pandehurit duhet të qëndrojnë në paraburgim deri sa Gjykata Themelore e Gjilanit të marrë një vendim mbi masën e sigurimit të pranisë së tyre. Mbetet në diskrecionin e Gjykatës Themelore të Gjilanit të bëjë vlerësimin se cila masë e sigurisë e përcaktuar me Kodit e Procedurës mjafton për të siguruar praninë e të pandehurve në procedurë. Megjithatë, Gjykata Themelore duhet ta merr vendimin sa më parë.

PËRFUNDIM

Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.



**GJKATA SUPREME E KOSOVËS
PRISHTINË**

PML-241/15

Kryetare e kolegjit

Anna Adamska - Gallant

Gjyqtare e EULEX-it

Procesmbajtës

Adnan Isufi,

Këshilltar ligjor i EULEX-it


Anëtarët e kolegjit:

Krassimir Mazgalov

Gjyqtar i EULEX-it

Nesrin Lushta

Gjyqtare e Gjykatës Supreme



Republika e Kosovës



Republika Kosovo

**SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE**

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik